URDHËR
Nr. 180, datë 30.12.2025

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR NXITJEN DHE LEHTËSIMIN E EKSPORTEVE 2026-2030.

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të VKM nr. 516, datë 25.9.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacioni", të "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të VKM nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", masa 1.1.6 "Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarëzimi i ndërrmarjes duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë dhe mbështejen e zinxhirit të vlerës për industritë e përzgjedhura me potencial rritje",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve 2026-2030, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit për zbatimin dhe monitorimin e Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve 2026 – 2030.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DHE INOVACIONIT

PROGRAMI
PËR NXITJEN DHE LEHTËSIMIN E EKSPORTEVE
(2026-2030)

Përmbajtja

1.Përmbledhje ekzekutive

2.Hyrje

3.Metodologjia

4.Trendet e tregtisë botërore

4.1 Ndryshimet gjeopolitike, proteksionizmi dhe fragmentimi i tregtisë

4.2 Ndikimi i digjitalizimit në tregti

4.3 Tregtia e gjelbër dhe ekonomia qarkulluese

4.4 Rreziqet

5.Pozicioni aktual i Shqipërisë në tregtinë ndërkombëtare

5.1. Performanca e përgjithshme e eksporteve (mallra dhe shërbime)

5.2. Pozicioni i Shqipërisë në indekset ndërkombëtare të tregtisë dhe konkurrueshmërisë

6.Mbështetja për eksportet dhe programet

6.1 Roli i institucioneve dhe politikave qeveritare Shqiptare

6.1.1 Mbështetja institucionale

6.2.1 Politikat dhe procedurat

6.2 Asistenca ndërkombëtare

6.3 Sinergjitë, sfidat dhe rekomandimet

7.Vështrim i detajuar mbi sektorët kryesorë të eksportit

7.1. Eksportet e mallrave: sektorët kryesorë dhe situata e detajuar

7.1.1 Ushqim & Pije

7.1.2. Materialet e Ndërtimit

7.1.3. Tekstile & Lekurë

7.1.4. Metalet

7.2. Eksportet e shërbimeve: Sektorët kryesorë dhe situata e detajuar

7.2.1. Turizmi

7.2.2. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Shërbimet e Proçesimit të Biznesit (BPO)

7.3 Sektor horizontal - Digjitalizimi dhe inovacioni

8.Analiza SWOT e Eksporteve Shqiptare

8.1. Pikat e Forta

8.2. Dobësitë

8.3. Mundësitë

8.4. Kërcënimet

8.5 Sfidat dhe potencialet
9.Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (PNLE) 2026-2030
9.1. Lidhja me Integrimin në BE
9.2. Lidhja me dokumenta strategjike
9.2.1 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve
9.2.2 Plani i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor (New growth plan for the Western Balkans)
9.2.3 Plani i Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM 2.0 Action plan)
9.2.4 Agjenda Kombëtare e Reformave
9.2.5 Strategjia e Specializimit Inteligjent
9.2.6 Programi Reformave Ekonomike (ERP)
9.3. Objektivat specifikë
9.4. Shtyllat Kryesore të Programit
9.5. Masat e detajuara, institucionet dhe afatet kohore
1.Objektivi i përgjithshëm 1 – Aksesi në tregje dhe promovim
2.Objektivi i përgjithshëm 2 - Lehtësimi i Barrierave
3.Objektivi i përgjithshëm 3 - Mbështetje Financiare
4.Objektivi i përgjithshëm 4 - Fuqizim kapacitetesh dhe koordinim
9.6. Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit

Lista e shkurtimeve

AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKR	Agjenda Kombëtare e Reformave
AKSHE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ASB	Këshillimi për Bizneset e Vogla
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Europian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BMZ	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
BP6	Ballkanit Perëndimor 6
BPO	Shërbimet e Proçesimit të Biznesit
BSO	Organizatat Mbështetëse të Biznesit
CAP	Politika e përbashkët bujqësore
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
CPF	Kuadri i Partneritetit të Vendit
CPI	Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
CRM	Tregu i Përbashkët Rajonal
DIH	Qendrat e Inovacionit Digjital
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EFSD+	Fondi Europian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus
EFTA	European Free Trade Association
EIT Raw Materials	Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para
ERP	Programi i Reformës Ekonomike
GII	Indeksi Global i Inovacionit
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GSP	Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave
ICT	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
ITC	Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë
ITMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifës
KEK	Këshilli Ekonomik Kombëtar
KKLT	Këshilli Koordinues për Lehtësimin e Tregtisë
LPI	Indeksi i Performancës Logjistike
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MTL	Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NCTS	Sistemi i ri i Kompjuterizuar i Transitit
NECP	Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCI	Indeksi i Kompleksitetit të Produktit
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QTTB	Qendra për Transferimin e Teknologjive Bujqësore
R&D	Kërkim dhe Zhvillim
RCC	Këshilli Bashkëpunimit Rajonal
RI	Reforma Indikative
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECO	Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike
SHMKSH	Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit
SIPPO	Programi Zviceran i Promovimit të Importit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SZHBI	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve
TEDA	Zonë e Zhvillimit Teknologjik dhe Ekonomik
UBT	Universiteti Bujqësor i Tiranës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkura për Zhvillim Ndërkombëtar
UT	Universiteti i Tiranës

1. Përmbledhje ekzekutive

Peizazhi ekonomik global ndodhet në një periudhë të thellë transformimi, të karakterizuar nga rritja e proteksionizmit, fragmentimi i tregtisë ndërkombëtare, përshpejtimi i procesit të digjitalizimit dhe nevoja urgjente për zhvillim të qëndrueshëm. Këto zhvillime po ndikojnë ndjeshëm në mënyrën se si ekonomitë kombëtare operojnë, krijojnë vlerë dhe integrohen në zinxhirët globalë të furnizimit. Në këtë kontekst dinamik dhe shpeshherë të pasigurt, Shqipëria, si një ekonomi e vogël, me varësi të lartë nga importet dhe me një strukturë ku sektori i shërbimeve është në rritje ndërkohë që eksportet e mallrave janë në rënie, përballet me sfida të vazhdueshme, por edhe me mundësi të reja për të forcuar pozicionin e saj në tregjet ndërkombëtare.

Analiza aktuale tregon se rritja ekonomike e Shqipërisë mbështetet kryesisht në kërkesën e brendshme, sektorin e turizmit dhe industrinë e ndërtimit. Struktura e eksporteve mbetet e përqendruar në produkte me vlerë të shtuar të ulët dhe me një varësi të lartë nga tregu i Bashkimit Evropian, duke e ekspozuar ekonominë ndaj rreziqeve të përqendrimit gjeografik dhe sektorial.

Ndërkohë, marrëveshjet rajonale si CEFTA kanë pasur një ndikim pozitiv në nxitjen e eksporteve, por barrierat jotarifore dhe mungesa e harmonizimit të standardeve teknike vazhdojnë të kufizojnë potencialin e plotë të tregtisë ndërkombëtare. Për më tepër, procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian paraqet një mundësi strategjike për të zgjeruar aksesin në fondet e BE-së dhe për të zhvilluar sektorë prioritarë si bujqësia dhe energjia e rinovueshme. Megjithatë, ky proces shoqërohet me sfida të rëndësishme që kërkojnë një ristrukturim të mirëmenaxhuar të ekonomisë, për të zbutur ndikimet e mundshme negative si humbjet fiskale dhe kostot e përshtatjes me acquis communautaire të BE-së.

Ky dokument ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të pozicionit tregtar të Shqipërisë, përmes analizës së marrëveshjeve tregtare ekzistuese, masave të mbështetjes qeveritare dhe sfidave të biznesit. Një analizë e thelluar SWOT identifikon pikat kyçe të sistemit aktual të eksporteve dhe përcakton drejtimet strategjike për ndërhyrje.

Bazuar në këtë analizë, propozohet "Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (PNLE) 2025–2030".

Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve synon të rrisë vlerën e eksporteve të Shqipërisë, të zgjerojë shtrirjen e tyre globale dhe të sigurojë prosperitet ekonomik afatgjatë, duke qenë ngushtë i lidhur me procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe përmbushjen e kritereve ekonomike të anëtarësimit.

Programi i propozuar bazohet në shtylla strategjike të fokusuara në rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e zinxhirit të vlerës, diversifikimin e tregjeve dhe produkteve, forcimin e mjedisit të biznesit dhe mbështetjen institucionale, si dhe shfrytëzimin e tranzicionit të gjelbër dhe digjitalizimit.

2. Hyrje

Në përputhje me objektivat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) dhe programit GIZ ProSEED 2.0, në vazhdimësi të projektit "Përmirësimi i Promovimit të Eksporteve pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", është dakordësuar zhvillimi i mëtejshëm i projektit, me qëllim hartimin e "Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (PNLE) 2025-2030", si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale pranë MEI.

Hartimi i këtij programi është realizuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me mbështetje të ekspertizës së GIZ, me synimin për të zhvilluar një dokument strategjik gjithëpërfshirës që mbështet rritjen e qëndrueshme të eksporteve shqiptare, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Në kuadër të fazës së parë të projektit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit nëpërmjet mbështetjes së GIZ ka krijuar mundësinë e realizimit me sukses të trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit të AIDA-s dhe ka konceptuar e implementuar tre shërbime thelbësore për përmirësimin e promovimit të eksporteve, të cilat përfshijnë:

1. Kërkim & analizë
2. Gatishmërinë për eksport
3. Shërbimin e ndërmjetësimit të bizneseve (matchmaking)

Përmes këtyre shërbimeve, stafi i AIDA-s ka arritur të ofrojë mbështetje të specializuar për kompanitë e interesuara në fushën e eksporteve, duke rritur kapacitetet e tyre edhe si institucion promovues i eksporteve. Për sa i përket vazhdimësisë së projektit, në këtë dokument do të prezantohet analiza për hartimin e "Programit Kombëtar të Nxitjes së Eksporteve," një instrument strategjik që synon të shërbejë si udhërrëfyes për të gjitha palët e interesuara në këtë fushë.

Programi do të jetë i ndarë në dy faza, të cilat ndërthuren dhe plotësojnë njëra-tjetrën në mënyrë të integruar. Faza e parë, Rishikimi i Programit dhe Zhvillimi i Kornizës së Politikave, fokusohet në analizimin e situatës aktuale të eksporteve shqiptare, identifikimin e sfidave dhe mundësive, si dhe hartimin e një kornize të qartë politike dhe strategjike që të mund të orientojë zhvillimin e sektorit të eksporteve në përputhje me prioritetet kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Faza e dytë, Ndërtimi i Kapaciteteve për MEI dhe AIDA, synon fuqizimin e kapaciteteve institucionale për të ofruar shërbime të dedikuara për eksportuesit shqiptarë, duke përfshirë ofrimin e trajnimeve, asistencës teknike, dhe të metodologjive të avancuara për promovimin e eksporteve. Këto dy faza do të shërbejnë si baza për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm mbështetjeje për eksportuesit shqiptarë, duke u mundësuar atyre akses më të lehtë në tregjet ndërkombëtare dhe rritjen e konkurrueshmërisë në skenën globale.

3. Metodologjia

Programi është i ndarë në dy faza: 1) Analiza e Situatës dhe Zhvillimi i Kornizës së Politikave dhe 2) Ndërtimi i Kapaciteteve për MEI dhe AIDA, të cilat janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe shërbejnë si bazë e qëndrueshme për mbështetjen e eksportuesve shqiptarë, duke krijuar një sistem të integruar shërbimesh dhe instrumentesh që forcojnë aftësinë e tyre për të hyrë dhe konkurruar me sukses në tregjet ndërkombëtare.

Gjatë fazës së parë janë kryer aktivitetet si më poshtë:

- **Kërkim (Desk Research):** Është rishikuar në mënyrë të detajuar kuadri aktual i politikave tregtare në Shqipëri, me fokus të veçantë në instrumentet dhe mekanizmat që ndikojnë mbi zhvillimin dhe nxitjen e eksporteve. Gjatë këtij procesi, janë analizuar trendet globale të promovimit të eksporteve, përfshirë modelet e suksesshme të vendeve të tjera dhe qasjet inovative në mbështetjen e ndërmarrjeve eksportuese. Një aspekt kyç ka qenë edhe identifikimi dhe shqyrtimi i praktikave më të mira ndërkombëtare, të cilat mund të përshtaten dhe aplikohen në kontekstin shqiptar, për të ndërtuar një program sa më efektiv dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete.
- **Konsultime me aktorët:** Janë zhvilluar konsultime të targetuara me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEI), shoqata të ndryshme të biznesit, si dhe me vetë eksportuesit aktivë në sektorë të ndryshëm. Në dakordësi me MEI, u identifikuan gjashtë sektorë prioritarë me potencial të lartë eksportues. Për secilin prej këtyre sektorëve janë organizuar takime konsultative me përfaqësues të bizneseve përkatëse. Nga këta gjashtë sektorë, katër i përkasin eksporteve të mallrave, ndërsa dy sektorë përfshijnë shërbimet. Sektorët e përzgjedhur janë: 1) sektori i pijeve dhe ushqimit, 2) sektori i materialeve të ndërtimit, 3) sektori i tekstileve dhe lëkurës, 4) sektori i metaleve, 5) sektori i shërbimeve të nënkontraktimit (BPO) dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), 6) sektori i turizmit. Përmes këtyre konsultimeve është mbledhur informacion cilësor i vlefshëm mbi sfidat praktike me të cilat përballen bizneset në procesin e eksportit, si dhe mbi nevojat konkrete për mbështetje institucionale. Perspektivat e marra nga bizneset janë përdorur si bazë për të formësuar më tej elementet kryesore të Programit, duke siguruar që ai të adresojë në mënyrë të drejtpërdrejtë problematikat reale dhe të jetë në përputhje me prioritetet e komunitetit të eksportuesve.
- **Analiza e të dhënave:** Si pjesë e procesit të përgatitjes së Programit, është realizuar një analizë e detajuar e të dhënave të disponueshme mbi tregtinë, investimet dhe tregjet e synuara. Kjo analizë ka pasur për qëllim identifikimin e sektorëve me potencial të lartë për zhvillimin e mëtejshëm të eksporteve shqiptare. Në kuadër të analizës janë shqyrtuar tendencat e fundit të eksporteve, destinacionet kryesore të tregtisë, profilet e sektorëve me rritje të qëndrueshme, si dhe mundësitë për diversifikimin e tregjeve. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë faktorë të tillë si barrierat tarifore dhe jotarifore, kërkesat rregullatore në tregjet ndërkombëtare dhe mjedisi i investimeve. Rezultatet e analizës kanë kontribuar në vendosjen e prioriteteve

strategjike të Programit, duke mundësuar që ndërhyrjet e planifikuara të përqendrohen në fushat me ndikimin më të madh për përmirësimin dhe rritjen e eksporteve. Vendimmarrja është bazuar në informacion të qartë, të përditësuar dhe të mbështetur në evidenca konkrete.

- **Plani i veprimit**: Bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e dala nga procesi i analizës dhe konsultimeve me aktorët, është hartuar një Plan i Veprimit i detajuar për zbatimin e Programit. Plani përfshin masa konkrete të orientuara drejt mbështetjes së eksporteve, duke adresuar ndërhyrje të tilla si: përmirësimi i aksesit të ndërmarrjeve në instrumente të financimit të eksportit, forcimi i strategjive të promovimit të produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i mekanizmave lehtësues për proceset e eksportit. Plani i Veprimit është ndërtuar mbi një kornizë të qartë implementimi, që përcakton përgjegjësitë institucionale, afatet kohore dhe indikatorët e matjes së progresit. Gjithashtu, është parashikuar një mekanizëm i strukturuar për monitorimin e zbatimit dhe për rivlerësimin periodik të masave, me qëllim garantimin e efektivitetit dhe përshtatjen dinamike të Programit ndaj zhvillimeve të tregut dhe nevojave të biznesit.

Gjatë fazës së dytë, e cila do tw fillojw zbatimin pas miratimit tw kwtij dokumenti politik me qwllim monitorimin dhe zbatimin e tij do të zhvillohen aktivitetet si më poshtë:

- **Vlerësimi i nevojave për trajnim:** Do të realizohet një vlerësim i nevojave për trajnim, me qëllim identifikimin e boshllëqeve specifike të njohurive dhe kufizimeve në kapacitete të stafit të MEI dhe AIDA, duke siguruar që përmbajtja e trajnimeve të jetë e përshtatur dhe e orientuar drejt nevojave konkrete.
- **Hartimi i programeve të trajnimit:** Do të hartohet një program trajnimi i personalizuar për të adresuar këto nevoja, duke përfshirë tema prioritare si: gatishmëria për eksport, strategjitë e hyrjes në tregje, instrumentet e financimit, përputhshmëria me rregulloret e BE-së dhe koordinimi institucional, me synim përmirësimin e efektivitetit operacional.
- **Zhvillimi i sesioneve të trajnimit**: Do të zhvillohen tre deri në katër sesione trajnimi interaktive, të cilat do të organizohen fizikisht ose në format hibrid, dhe do të përfshijnë ushtrime praktike, raste studimore dhe simulime të politikave, me qëllim nxitjen e shkëmbimit të përvojave mes pjesëmarrësve si dhe rritjen e aftësive.
- **Vlerësim pas trajnimit:** Pas përfundimit të trajnimeve, do të realizohet një vlerësim përfundimtar për të matur përfitimet në njohuri, për të mbledhur komente nga pjesëmarrësit dhe për të identifikuar fushat specifike që kërkojnë mbështetje të mëtejshme dhe përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve.

4. Trendet e tregtisë botërore

4.1 Ndryshimet gjeopolitike, proteksionizmi dhe fragmentimi i tregtisë

Ekonomia globale po hyn në një epokë të re, e karakterizuar nga tensione të shtuara gjeopolitike dhe rritje e proteksionizmit. Kjo pasiguri në politikat tregtare është në nivele historike, duke rënduar

besimin e biznesit dhe investimet[1].

Në kushtet aktuale, megjithëse tregtia globale e mallrave i tejkaloi pritshmëritë në gjysmën e parë të vitit 2025, e nxitur nga rritja e shpenzimeve për produkte të lidhura me inteligjencën artificiale, rritja paraprake e importeve në Amerikën e Veriut përpara vendosjes së tarifave dhe intensifikimi i tregtisë me pjesën tjetër të botës, perspektiva afatmesme mbetet e pasigurt. Në këtë kontekst, ekonomistët e OBT-së[2] kanë rishikuar në rritje parashikimin e tregtisë botërore të mallrave për vitin 2025 në 2.4%, nga 0.9% më parë. Megjithatë, për vitin 2026 parashikohet një ngadalësim i ndjeshëm i rritjes në vetëm 0.5%.

Ndërkohë, tensionet tregtare, veçanërisht konflikti ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kinës, pritet të ndikojnë ndjeshëm në riorientimin e flukseve tregtare. Eksportet nga Amerika e Veriut parashikohet të pësojnë rënie, ndërsa eksportet kineze të mallrave pritet të rriten me 4% deri në 9% drejt tregjeve jashtë këtij rajoni. Kjo dinamikë globale krijon hapësira të reja për vende të tjera, të cilat mund të pozicionohen për të zëvendësuar pjesërisht ofertën në tregun amerikan, veçanërisht në sektorë si tekstilet, veshjet dhe pajisjet elektrike. Paralelisht, rritja e eksporteve globale të shërbimeve pritet të ngadalësohet nga 6.8% në vitin 2024 në 4.6% në vitin 2025 dhe 4.4% në vitin 2026.

Ky proteksionizëm në rritje paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për eksportet Shqiptare. Për një ekonomi të vogël, të varur nga importet si Shqipëria, kjo tendencë ka një ndikim të dyfishtë negative. Së pari, rritja e tarifave për mallrat e tregtuara globalisht ka të ngjarë të përkthehet në çmime më të larta importi për mallrat thelbësore të Shqipërisë si drithërat, nafta, pjesët e këmbimit industriale dhe produktet ushqimore[3]. Së dyti, nëse partnerët kryesorë tregtarë, si Bashkimi Evropian, përballen me tarifa më të larta nga fuqitë e tjera globale, ose nëse kërkesa globale bie për shkak të krizave të krijuara, kjo do të ndikojë negativisht në kërkesën për mallrat shqiptare.[4] Kjo vlen edhe më tepër për sektorët e industrisë "fason" si tekstilet dhe këpucët, të cilët janë shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në zinxhirët e furnizimit. Kjo cënueshmëri përkeqësohet nga varësia aktuale e lartë e Shqipërisë nga një treg i vetëm (BE) dhe fokusi i saj në eksportet me vlerë të shtuar të ulët. Prandaj, "Programi i Eksporteve" duhet të ketë për qëllim prioritar rezistencën ndaj goditjeve të jashtme. Kjo kërkon një qasje proaktive ndaj diversifikimit të tregut përtej varësisë aktuale të madhe nga BE-ja, duke kërkuar partnerë të rinj tregtarë.

Nga ana tjetër vërehet një fragmentizim në blloqe i tregtisë midis vendeve të përafërta gjeopolitikisht shpesh të referuara si "near shoring" ose "friend-shoring"[4]; avantazhi strategjik i Shqipërisë në këtë "bllokëzim"qëndron në lidhjet e forta tregtare që ka me BE-në.

4.2 Ndikimi i digjitalizimit në tregti

Në nivel kombëtar, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në digjitalizimin e shërbimeve të saj publike (95% e shërbimeve publike ofrohen vetëm online që nga Maji 2022). Portali e-Albania ka qenë aktiv që nga viti 2013, duke zgjeruar vazhdimisht shërbimet online për qytetarët, biznesin dhe administratën[5].

Megjithatë, parë në kontekstin e brendshëm situata nuk është në të njëjtën shkallë në NMV, duke

---

[1] https://www.tradeready.ca/2025/featured-stories/10-global-trade-trends-well-be-watching-in-2025/
[2] https://www.wto.org/english/news_e/archive_e/tfore_arc_e.htm
[3] https://altax.al/en/the-impact-of-the-global-tariff-war-on-an-economy-like-albania-and-the-need-for-self-defense/
[4] https://www.elibrary.imf.org/view/journals/001/2025/093/article-A001-en.xml
[5] https://www.ebrd.com/content/dam/ebrd_dxp/assets/pdfs/office-of-the-chief-economist/transition-report-archive/transition-report-2023/country-assessments-2023-24/transition-report-202324-country-assessments.pdf

krijuar një hendek digjital midis administratës publike dhe kapaciteteve operacionale të sektorit privat[6]. Ky hendek mund t'u krijojë eksportuesve shqiptarë disavantazh në një treg global që mbështetet gjithnjë e më shumë në vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe menaxhimin e digjitalizuar të zinxhirit të furnizimit.

Prandaj, "Programi i eksporteve" duhet të shkojë përtej digjitalizimit të shërbimeve publike dhe të promovojë në mënyrë aktive adoptimin e mjeteve dhe aftësive të avancuara digjitale brenda sektorit privat shqiptar, veçanërisht midis NVM-ve. Kjo përfshin lehtësimin e aksesit dhe trajnimit në platforma për marketingun digjital, tregtinë elektronike, menaxhim të zinxhirit të furnizimit dhe inteligjencë tregu në kohë reale. Zbutja e këtij hendeku të kapacitetit digjital do t'u mundësojë firmave shqiptare të përballen më mirë me dinamikat komplekse të tregtisë globale, të identifikojnë mundësi të reja tregu dhe të rrisin konkurrencën duke u përshtatur me ndryshimet e shpejta globale.

4.3 Tregtia e gjelbër dhe ekonomia qarkulluese

Peizazhi i tregtisë globale, gjithnjë e më tepër po merr formë nga kujdesi për mjedisin. Tregtia dhe rritja ekonomike kanë një ndikim të rëndësishëm në mjedis, duke nxitur vendet në zhvillim të përafrojnë politikat e tyre tregtare dhe të investimeve me parimet e ekonomisë së gjelbër për të adresuar sfidat mjedisore dhe për të përfituar nga një ekonomi qarkulluese.

Shtetet më të fuqishme po adoptojnë gjithnjë e më shumë rregulla që kanë në fokus mjedisin me qëllim përmbushjen e angazhimeve klimaterike, (si psh ato të parashikuara në Marrëveshjen e Parisit[7]), e të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aksesin në treg për vendet eksportuese.

Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë (ITC) ofron mbështetje të rëndësishme për vendet në zhvillim në adoptimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për rritjen e gjelbër dhe tregtinë e qëndrueshme, duke ofruar udhëzime teknike dhe ndërtim kapacitetesh për NVM-të mbi marrëveshjet tregtare të gjelbra dhe zinxhirin e gjelbër global të vlerës[8].

Koncepti i një ekonomie qarkulluese ofron mundësi të mëdha për ekonominë për të reduktuar mbetjet, për të qarkulluar burimet dhe për të rigjeneruar natyrën, duke çuar në uljen e ndotjes, emetimeve dhe mbetjeve, si dhe në rritjen e vendeve të punës dhe prosperitetit. Për bizneset e vogla, qarkullimi mund të ulë kostot e prodhimit, të rrisë produktivitetin dhe të nxisë inovacionin[9].

Ky tranzicion i gjelbër nuk është më thjesht një aspiratë mjedisore, por domosdoshmëri për qasjen në treg dhe gjithashtu përbën një avantazh strategjik konkurrues për Shqipërinë. Fakti që BE është duke përshtatur gjithnjë e më shumë rregulla të përqendruara në mjedis, është veçanërisht i rëndësishëm për Shqipërinë, e cila pjesën më të madhe të eksporteve i ka drejt BE dhe që gjithashtu po punon për antarësimin në BE[10].

Shqipëria ka miratuar zyrtarisht Planin e saj Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) në Dhjetor 2021, duke demostruar kështu përpjekjet e saj për tranzicionin energjetik[11]. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po mbështet gjithashtu në mënyrë aktive tranzicionin e ekonomisë së gjelbër të Shqipërisë përmes investimeve në burime të rinovueshme, efikasitet energjetik dhe dialog

---

[6] https://www.ilo.org/projects-and-partnerships/projects/lifelong-empowerment-and-protection-albania-leap
[7] https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement
[8] https://www.intracen.org/our-work/topics/sustainability/sustainable-trade-and-investment
[9] https://www.intracen.org/our-work/topics/sustainability/green-competitiveness
[10] https://iai.al/wp-content/uploads/2025/06/The-Impact-of-EU-Accession-on-Three-Consequential-Sectors-of-Albanian-Economy.pdf
[11] https://www.ebrd.com/content/dam/ebrd_dxp/assets/pdfs/office-of-the-chief-economist/transition-report-archive/transition-report-2022/country-assessments-2022-23/transition-report-202223-country-assessments.pdf

politikash[12].

Varësia gati e plotë e vendit nga hidrocentralet për prodhimin e energjisë elektrike lejon përqendrimin e përpjekjeve për dekarbonizim në sektorë të tjerë me emetime intensive si industria. Kjo e pozicionon Shqipërinë në mënyrë unike për t'u bërë një lider rajonal në infrastrukturën e energjisë së rinovueshme dhe lëvizshmërisë elektrike[13].

Prandaj, "Programi i eksporteve" duhet të ketë parimet e ekonomisë së gjelbër dhe praktikat e tregtisë së qëndrueshme në thelb të tij. Kjo përfshin jo vetëm ndihmën e eksportuesve ekzistues në përmbushjen e standardeve të rrepta mjedisore dhe të qëndrueshmërisë të BE-së (p.sh. siguria ushqimore dhe gjurmueshmëria), por edhe promovimin dhe stimulimin aktiv të zhvillimit të sektorëve të rinj të eksportit "të gjelbër". Mbështetja e NVM-ve në adoptimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese mund të rrisë gjithashtu konkurrencën e tyre duke ulur kostot dhe duke nxitur inovacionin, duke transformuar kështu një barrë pajtueshmërie në një avantazh strategjik[14].

4.4 Rreziqet

Ngushtimi i hendekut të rritjes së proteksionizmit, fragmentimit të tregtisë dhe kërkesat për tregti të gjelbër dhe ekonomisë qarkulluese kërkojnë një kujdes të madh në hartimin e programit të eksporteve. Struktura aktuale e eksporteve, e përqendruar në mallra me vlerë të shtuar të ulët dhe varësia e lartë nga tregu i BE-së, i bën eksportet shqiptare të cenueshme ndaj goditjeve ekonomike dhe gjeopolitike globale.

Diversifikimi i tregjeve të eksportit dhe fuqizimi i prodhimit vendas nuk përfaqësojnë vetëm një strategji për nxitjen e rritjes ekonomike, por shërbejnë gjithashtu si një mekanizëm mbrojtës dhe garanci sigurie në një kontekst global gjithnjë e më të pasigurt, ku ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit mund të ndodhin papritur dhe me pasoja të ndjeshme.

Prandaj, një program i fortë eksporti duhet të prioritizojë diversifikimin e tregjeve të eksportit përtej varësisë së saj aktuale nga BE-ja për të zbutur rreziqet. Njëkohësisht, rritja e prodhimit vendas të mallrave është thelbësore për rritjen e sigurisë ekonomike.

Programi i propozuar i eksportit adopton një strategji diversifikimi holistike dhe proaktive. Kjo përfshin diversifikimin e produkteve, duke kaluar përtej mallrave me vlerë të shtuar të ulët në prodhimin me vlerë më të lartë dhe shërbimet e specializuara, duke nxitur inovacionin dhe adoptimin e teknologjisë. Ai përfshin gjithashtu diversifikimin aktiv të tregut, identifikimin dhe depërtimin në tregje të reja eksporti përtej BE-së për të reduktuar rrezikun e përqendrimit. Së fundmi investimet strategjike në sektorët kyç si bujqësia dhe prodhimi i energjisë janë thelbësorë për të reduktuar varësinë nga importet e mallrave, duke rritur kështu stabilitetin e përgjithshëm ekonomik e duke i lejuar vendit të përballojë më mirë goditjet e jashtme.

5. Pozicioni aktual i Shqipërisë në tregtinë ndërkombëtare

---

[12] https://www.ebrd.com/content/dam/ebrd_dxp/assets/pdfs/country-strategies/albania/Albania_Snapshot_For_Publication_14062023.pdf

[13] https://iai.al/wp-content/uploads/2025/06/The-Impact-of-EU-Accession-on-Three-Consequential-Sectors-of-Albanian-Economy.pdf

[14] https://www.intracen.org/our-work/topics/sustainability/green-competitiveness

Shqipëria, si një ekonomi në tranzicion në Ballkanin Perëndimor, ka demonstruar rritje të fortë ekonomike në vitet e fundit, me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) të saj i cili shënoi një rritje me rreth 4% në vitin 2024[15]. Kjo rritje është nxitur kryesisht nga kërkesa e fortë e brendshme, një rimëkëmbje e rëndësishme në sektorin e turizmit dhe aktiviteti i qëndrueshëm i ndërtimit.

Shqipëria ka shënuar përparim të konsiderueshëm në integrimin e saj në tregtinë ndërkombëtare, megjithatë, pozicioni i saj mbetet i karakterizuar nga një disbalancë e qëndrueshme midis importeve dhe eksporteve, si dhe nga një strukturë eksporti ende e kufizuar në diversitet dhe me nivel të ulët të vlerës së shtuar. Vlerësimi i Lekut shqiptar gjatë viteve 2023 dhe 2024 ka ndikuar negativisht në konkurrueshmërinë e eksporteve të mallrave, duke krijuar një mjedis të pafavorshëm të jashtëm dhe duke kontribuar në rënien e këtij segmenti, ndërkohë që eksportet e shërbimeve kanë vijuar trendin e tyre pozitiv të zgjerimit.

5.1. Performanca e përgjithshme e eksporteve (mallra dhe shërbime)

Shqipëria ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në eksporte gjatë viteve të fundit. Në vitin 2023, vendi eksportoi produkte me vlerë prej 11.2 miliardë USD, duke shënuar një rritje mesatare vjetore prej 7.2% gjatë pesë viteve të fundit, e cila ka tejkaluar rritjen e përgjithshme ekonomike. Pavarësisht kësaj, Shqipëria regjistroi një deficit tregtar në mallra dhe shërbime, me importe që arritën në 12.7 miliardë USD në të njëjtin vit[16].

Figura 1.



Në vitin 2024, rritja ekonomike e Shqipërisë mbeti e qëndrueshme në rreth 4%, e nxitur kryesisht nga sektori i shërbimeve, veçanërisht turizmi, dhe aktiviteti i ndërtimit. Megjithatë, eksportet neto patën

[15] https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/ecofin-council-joint-conclusions-economic-and-financial-dialogue-partners-region-13-may-2025_en
[16] https://atlas.hks.harvard.edu/countries/8/export-basket

një ndikim negativ në këtë rritje, dhe deficiti i llogarisë korrente u zgjerua gjatë tremujorit të parë deri në të tretin e vitit 2024, për shkak të rënies së eksporteve të mallrave dhe rritjes së importeve[17].

Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 2024, eksportet kryesore të mallrave të Shqipërisë ishin të përqendruara në disa sektorë kyç: tekstile dhe këpucë (28.5%), minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike (18,3%), materiale ndërtimi dhe metale (17.6%), ushqime, pije dhe duhan (14.4%), dhe makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi (10,.2%).

Tabela 1. Tregtia e jashtme sipas produkteve (milionë lekë)

EKSPORTET (FOB)	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Ushqime, pije, duhan	44,455	51,671	55,638	53,252
Minerale, lëndë djegëse, energji	67,959	101,552	84,981	67,486
Produkte kimike dhe plastike	10,651	17,586	15,783	15,174
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2,170	2,887	2,613	2,026
Prodhime druri dhe letre	10,146	14,281	11,176	9,929
Tekstile dhe këpucë	112,445	135,203	126,261	105,053
Materiale ndërtimi dhe metale	80,065	105,354	83,115	65,086
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	28,651	39,548	38,974	37,441
Të tjera	10,547	12,493	11,824	13,383
Totali i Eksporteve	367,089	480,575	430,366	368,829

Burmi: INSTAT

Në sektorin e shërbimeve, "Udhëtimi" (turizmi) dominon në mënyrë dërrmuese, duke përbërë 40.53% të totalit të eksporteve në vitin 2023[18].

Tregjet e eksportit të mallrave të Shqipërisë janë shumë të përqendruara gjeografikisht. Në vitin 2024, Italia ishte partneri më i madh i eksportit, duke marrë 43.9% të eksporteve shqiptare. Partnerë të tjerë të rëndësishëm përfshijnë Kosovën (10.0%), Greqinë (6.0%), Spanjën (3.5%) dhe Maqedoninë e Veriut (3.2%). Në përgjithësi, vendet e BE-së përbënin 72% të eksporteve të Shqipërisë në vitin 2023, ndërsa vendet e CEFTA-s 18%. Kjo varësi e madhe nga tregu i BE-së krijon një rrezik të rëndësishëm përqendrimi[19].

Tabela 2. Eksporti sipas vendeve, 2021-2024 (milionë lekë)

Shtete	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
IT Italia	155,624	208,936	187,794	162,086
XK Kosova	37,651	37,729	40,859	36,831
GR Greqia	21,320	23,405	26,941	22,211
DE Gjermania	20,147	31,960	23,098	22,018
ES Spanja	23,573	23,333	18,843	12,978
MK Maqedonia e Veriut	12,381	19,288	15,978	11,803
CN Kina	9,057	9,813	10,074	10,429
RS Serbia	9,979	13,487	9,923	8,271
ME Mali i Zi	5,951	7,458	9,583	7,466

[17] https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview
[18] https://atlas.hks.harvard.edu/countries/8/export-basket
[19] INSTAT tregtia me jashtë

US Shtetet e Bashkuara	4,923	13,461	9,760	7,039
Vendet e tjera	66,483	91,705	77,514	67,697
Totali eksporteve	367,089	480,575	430,366	368,829

Burimi INSTAT

Të dhënat pasqyrojnë qartë një divergjencë strukturore në performancën e eksporteve shqiptare: sektori i eksporteve të mallrave paraqitet në stanjacion, ndërsa sektori i eksporteve të shërbimeve, veçanërisht turizmi, po përjeton një zgjerim të shpejtë. Megjithëse zhvillimi i turizmit përbën një avantazh strategjik për ekonominë, mbështetja e tepruar në një sektor të vetëm, madje edhe brenda fushës së shërbimeve, rrit ndjeshëm ekspozimin ndaj goditjeve të jashtme, si krizat gjeopolitike apo emergjencat shëndetësore globale që prekin mobilitetin dhe udhëtimet.

Programi i eksporteve duhet të adoptojë një qasje të dyfishtë. Së pari, ai duhet të zbatojë masa të synuara dhe të fuqishme për të rigjallëruar dhe rritur konkurrencën e eksporteve të mallrave të Shqipërisë, duke u fokusuar në transformimin e vlerës së shtuar dhe diversifikimin për të zbutur ndikimet negative të mjedisit të jashtëm dhe mbivlerësimit të Lekut. Së dyti, ndërsa shfrytëzon suksesin e turizmit, ai duhet të eksplorojë dhe promovojë në mënyrë aktive diversifikimin brenda sektorit më të gjerë të shërbimeve, si IT, shërbimet financiare ose outsourcing të proceseve të biznesit, për të ndërtuar një bazë eksporti shërbimesh më rezistente dhe shumëplanëshe. Kjo strategji e balancuar është thelbësore për stabilitetin ekonomik afatgjatë dhe rritjen e qëndrueshme të eksportit.

Pavarësisht rritjes së përgjithshme të eksporteve në vitet e fundit, baza eksportuese e Shqipërisë mbetet strukturalisht e ngushtë, me një përqindje shumë të ulët të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) që janë aktive në eksport. Shumica e NVM-ve operojnë kryesisht në tregun e brendshëm dhe përballen me barriera të shumta për ndërkombëtarizim, përfshirë mungesën e informacionit mbi tregjet e huaja, kapacitetet e kufizuara prodhuese dhe menaxheriale, mungesën e certifikimeve ndërkombëtare, si dhe vështirësitë në aksesin në financim dhe instrumente mbështetëse.

Kjo situatë evidenton nevojën për një qasje më të synuar të Programit Kombëtar të Eksporteve, e cila të adresojë jo vetëm nevojat e eksportuesve ekzistues, por edhe të fokusohet në mënyrë specifike në mbështetjen e NVM-ve jo-eksportuese dhe eksportuesve potencialë, me qëllim zgjerimin gradual të bazës eksportuese dhe rritjen e qëndrueshmërisë së eksporteve në afat të mesëm dhe afatgjatë.

5.2. Pozicioni i Shqipërisë në indekset ndërkombëtare të tregtisë dhe konkurrueshmërisë

Pozicioni i Shqipërisë në indekset ndërkombëtare ofron një pamje të qartë të sfidave strukturore që ndikojnë konkurrueshmërinë e eksporteve.

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (Corruption Perception Index - CPI)[20] i Transparency International. Në vitin 2024, Shqipëria renditej në vendin e 80 (nga 180 shtete) me një rezultat prej 42 pikësh (nga 100[21]), duke u pozicionuar në mesataren botërore (43 pikë) dhe duke u përmirësuar me 5 pikë nga viti 2023 dhe duke u ngjitur edhe në renditje me 18 pozicione (në vitin 2023 renditej në vendin e 98). Rritja në renditje i dedikohet kryesisht rritjes së besimit në publik të SPAK.

[20] https://www.transparency.org/en/cpi/2024/index/alb
[21] 100 pikë është mungesa e korrupsionit

Figura 2.



Indeksi i Performancës Logjistike (LPI) i Bankës Botërore[22]. Ky indeks i cili rendit vendet në dimensione të tilla si efikasiteti doganor, infrastuktura logjistike etj (gjithsej janë 6 dimensione) tregon se Shqipëria për vitin 2023 (matja e fundit) renditej relativisht poshtë (vendi i 97 nga 139 vende) dhe rezultat 2.5 (nga 5) duke theksuar sfidat në zinxhirin e furnizimit për eksport.

Figura 3.

Perspektivat Ekonomike i OECD. OECD monitoron dhe analizon zhvillimet ekonomike të

[22] https://lpi.worldbank.org/international/scorecard/radar/C/ALB/2023

vendeve, duke përfshirë edhe Shqipërinë, kryesisht në kontekstin e Ballkanit Perëndimor.

- Produktiviteti i Punës: Sipas OECD, produktiviteti i punës në Shqipëri mbetet relativisht i ulët krahasuar me vendet e BE-së dhe madje edhe me disa vende të tjera të Ballkanit Perëndimor. Përmirësimi i këtij treguesi kërkon reforma në sistemin e arsimit dhe trajnimin profesional. Në periudhën 2020-2023, produktiviteti i një punonjësi në Shqipëri ishte rreth 25.7% e nivelit të BE-së.
- Rreziku i Kreditimit për Eksportuesit: OECD[23] ka përmirësuar klasifikimin e rrezikut të vendit për Shqipërinë, duke e bërë atë më pak të rrezikshme për eksportuesit (si p.sh. agjencitë e kreditit të eksportit). Kjo tregon një vlerësim më pozitiv të stabilitetit ekonomik dhe aftësisë paguese të Shqipërisë.

OECD ka krijuar **Western Balkans Competitiveness Outlook**[24] data hub, ku janë matur krahasimisht shtetet e Ballkanit Perëndimor në 13 dimensione. Shqipëria ka një renditje mjaft të mirë në gati të gjithë dimensionet duke ardhur me rritje në çdo dimension (matjet janë bërë në vitin 2021 dhe 2024), por mbetet e fundit në rajon për nën-dimesione të tilla si "programet e promovimit të eksportit" dhe "agjencitë e promovimit të eksportit", dhe kalon vetëm Kosovën në dimensionin e aksesit në financë.

Figura 4.

Indeksi i Lirisë Ekonomike[25] (The Heritage Foundation) për vitin 2025 e klasifikon Shqipërinë në vendin e 50-të në botë nga 184 vende. Shqipëria ka një rezultat prej 66.6 pikë (ka rritje 1.8 pikë nga viti 2024) dhe renditet më lart se mesatarja botërore (prej 59.7 pikësh) por më ulët se mesatarja e rajonit (68.5 pikë), duke e klasifikuar ekonominë shqiptare si "mesatarisht të lirë" (*moderately free*). Në rajonin e Europës, Shqipëria renditet e 27-ta nga 44 vende. Vërehet një përmirësim në barrën tatimore, shëndetin fiskal dhe lirinë tregtare. Sidoqoftë, luhatjet politike në sistemin gjyqësor dhe prania e

[23] https://export.sk/en/bulgaria-and-albania-have-become-less-risky-for-exporters-according-to-the-oecd/
[24] https://westernbalkans-competitiveness.oecd.org/dimensions/TRADE/
[25] https://www.heritage.org/index/pages/country-pages/albania

vazhdueshme e korrupsionit vazhdojnë të ndikojnë negativisht në garantimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të pronës.

Figura 5.



Indeksi Global i Inovacionit (GII)[26] rendit ekonomitë botërore sipas aftësive të tyre të inovacionit. I përbërë nga afërsisht 80 tregues, GII synon të kapë aspektet shumëdimensionale të inovacionit. Shqipëria renditet e 38-ta midis 39 ekonomive në Evropë dhe e 84-ta midis 133 ekonomive të përfshira në raportin e GII 2024. Shqipëria shfaq mangësi të theksuara në dimensione kyçe si kapitali njerëzor dhe kërkimi shkencor, sofistikimi i biznesit dhe ai i tregut. Performanca e saj në këto fusha rezulton nën pritshmëritë që do të korrespondonin me nivelin aktual të zhvillimit ekonomik të vendit.

Figura 6.



Sipas raportit të **Indeksit të Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale** 2022[27] për vendet e Ballkanit

[26] https://www.wipo.int/edocs/gii-ranking/2024/al.pdf
[27] https://www.rcc.int/files/user/docs/43a521a624cf08523a2268a67a7be2ff.pdf

Perëndimor publikuar nga Këshilli Bashkëpunimit Rajonal (RCC) vendet e rajonit të BP6 në dimensionin e kapitalit njerëzor performojnë më dobët se mesatarja e BE kryesisht për shkak të nivelit të ulët të aftësive digjitale. Mali i Zi dhe Serbia kanë rezultatet më të larta ndërkohë Shqipëria renditet e fundit në rajon.

Figura 7.

Figure 5 Human Capital sub-dimensions, WB DESI 2022



Source: WB DESI Calculation, EU DESI 2022 (EU average)

6. Mbështetja për eksportet dhe programet

6.1 Roli i institucioneve dhe politikave qeveritare Shqiptare

Qeveria shqiptare, përmes një sërë institucionesh dhe politikash, luan një rol qendror në mbështetjen dhe rregullimin e sektorit të eksportit. Ky angazhim shkon nga promovimi i investimeve dhe ofrimi i mbështetjes financiare direkte për bizneset, te lehtësimi i procedurave doganore dhe harmonizimi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare.

6.1.1 Mbështetja institucionale

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave kombëtare të mbështetjes së eksporteve dhe zhvillimit ekonomik. Ajo luan një rol drejtues në formulimin e strategjive për promovimin e produkteve shqiptare jashtë vendit, si dhe në koordinimin ndërinstitucional të të gjitha iniciativave që lidhen me lehtësimin e eksportit dhe përmirësimin e klimës për ndërkombëtarizimin e biznesit.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) ka një rol të rëndësishëm përmes rrjetit të ambasadave dhe përfaqësive diplomatike, të cilat shërbejnë si pikë kontakti për ndërtimin e marrëdhënieve tregtare, promovimin e produkteve shqiptare dhe mbështetjen e bizneseve për të hyrë në tregje të reja ndërkombëtare. Kjo ministri është gjithashtu promotore e diplomacisë ekonomike.

Ministria e Financave (MF), luan rol në hartimin e politikave fiskale që ndikojnë drejtpërdrejt në

eksport, përfshirë rimbursimin e TVSH-së, lehtësitë tatimore, si dhe në negociatat dhe zbatimin e marrëveshjeve tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe që ndikojnë në aksesin në tregje.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është e përfshirë në mbështetjen e sektorëve agro-ushqimorë, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të eksporteve shqiptare. Kjo ministri bashkëpunon me AKU për sigurimin e standardeve për produktet që eksportohen dhe përmirësimin e certifikimeve dhe infrastrukturës agroindustriale. MBZHR ofron subvencione dhe programe mbështetëse për sektorin bujqësor, përfshirë ato me orientim eksportin. Për shembull, përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes për Bujqësinë, MBZHR ka dhënë mesatarisht rreth 40-50 milionë euro/vit në subvencione dhe grante për fermerët dhe agropërpunuesit, të cilat ndihmojnë një pjesë të eksportuesve të bujqësisë. Gjithashtu, programi IPARD (Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural), i financuar nga BE-ja, ka siguruar miliona euro për investime në fermat bujqësore dhe në agro-përpunim, duke përmirësuar cilësinë dhe standardet e produkteve të destinuara për eksport.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka ndikim në aspektin logjistik të eksporteve, përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore, portuale dhe energjetike, duke ndikuar në efikasitetin e zinxhirit të furnizimit dhe uljen e kostove për eksportuesit.

Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sportit (MTKS) ka në fokus promovimin e turizmit dhe zhvillimin e strategjive për rritjen e të ardhurave nga ky sektor duke hartuar e zbatuar programe specifike për zhvillimin e agroturizmit dhe diversifikimin e ofertës turistike, shpesh me mbështetjen e donatorëve si GIZ apo USAID. Ministria mbështet rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ofertës turistike, duke e lidhur atë me objektivat e promovimit ndërkombëtar dhe të brendimit kombëtar.

Ministria e Arsimit (MA) dhe **institucionet akademike** nën varësinë e saj luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve për eksport, përmes trajnimeve profesionale, programeve të specializuara për tregti ndërkombëtare dhe bashkëpunimit me sektorin privat për kërkim dhe inovacion.

Komiteti Kombëtar i Lehtësimit të Tregtisë (KKLT) përfaqëson një strukturë ndërinstitucionale që ka për qëllim të sigurojë bashkërendimin e të gjitha institucioneve publike për të thjeshtuar procedurat tregtare. Ky komitet mbështet integrimin rajonal dhe evropian të Shqipërisë përmes zbatimit të masave për lehtësimin e tregtisë dhe përmirësimin e qarkullimit të mallrave.

Këshilli Ekonomik Kombëtar (KEK), është një organ këshillimor pranë Kryeministrit, i cili luan një rol të rëndësishëm në garantimin e koherencës strategjike të politikave ekonomike kombëtare. KEK shërben si një platformë e strukturuar për dialog ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat, duke mundësuar përfshirjen e aktorëve të biznesit në procesin e hartimit dhe vlerësimit të politikave që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe tregtinë e jashtme. Gjithashtu, KEK mbështet koordinimin ndërinstitucional dhe promovon rekomandime për përmirësime rregullatore që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Këshilli i Investimeve, është një strukturë ndërinstitucionale e krijuar me qëllim përmirësimin e klimës së investimeve dhe dialogut mes qeverisë dhe komunitetit të biznesit. Ai funksionon si një mekanizëm këshillimor që adreson çështjet që ndikojnë në mjedisin e të bërit biznes, përfshirë barrierat për eksport dhe investime. Këshilli analizon problematikat që hasin investitorët dhe eksportuesit, propozon masa konkrete për reformim rregullator dhe ndihmon në formulimin e politikave që nxisin

konkurrueshmërinë dhe ndërkombëtarizimin e sipërmarrjeve shqiptare.

Autoritetet Doganore Shqiptare kanë për detyrë kontrollin dhe mbarëvajtjen e mënyrës së funksionimit të regjimit tregtar në Republiken e Shqipërise, duke ofruar mbrojtje dhe siguri për shoqërinë dhe bizneset vendase dhe ato partnere, duke mbrojtur interesat financiarë dhe ekonomikë të Shqipërisë dhe duke mbajtur një balancë të drejtë ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) luan një rol të rëndësishëm në administrimin fiskal të kompanive eksportuese, duke përfshirë trajtimin e rimbursimeve të TVSH-së dhe zbatimin e lehtësirave tatimore që mund të aplikohen për eksportuesit.

Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) promovon eksportet shqiptare përmes mbështetjes direkte për bizneset, pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare, misioneve tregtare dhe trajnimeve. Gjithashtu, ofron informacione mbi tregjet e huaja, partnerët potencialë dhe ndihmon në certifikimin dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për eksport.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është institucioni regullator kyç për sigurinë ushqimore, certifikimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore që eksportohen. Sigurimi i standardeve të larta të sigurisë ushqimore është thelbësor për eksportet bujqësore dhe agroushqimore, veçanërisht në BE, ku kërkesat janë shumë të rrepta.

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ofron harmonizimin e standardeve duke siguruar që produktet shqiptare të jenë të përputhshme me standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, gjë që është parakusht për pranimin e tyre në tregjet e jashtme.[28]

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal, janë urë lidhëse midis bizneseve dhe institucioneve publike. Ato ofrojnë shërbime për informim, ndërkombëtarizim, dhe çertifikata që lidhen me origjinën e produkteve, si dhe organizojnë forume ekonomike dhe misione tregtare.

Institucione të tjera që ndihmojnë në nxitjen e eksporteve dhe ndërkombëtarizimin e NVM-ve shqiptare janë Instituti i Statistikave (INSTAT), Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale etj.

6.2.1 Politikat dhe procedurat

Politikat makroekonomike dhe fiskale

Politikat makroekonomike dhe fiskale, të menaxhuara nga Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, janë thelbësore për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm dhe të favorshëm për eksportin.

Shqipëria ka ndjekur prej kohësh një politikë fiskale mjaft favorizuese për të ndihmuar prodhuesit me synim uljen e kostove dhe të nxitjen e zhvillimit bujqësor e industrial.

Tarifat doganore të një pjese të mirë të lendëve të para dhe të makinerive që përdoren në prodhim

[28] https://dps.gov.al/sq/standardet-shqiptare_p4.html

janë 0% prej vitesh dhe TVSH është hequr në import për makineri e pajisje në fushën e prodhimit industrial e bujqësor. Eksporti është i lirë nga taksa e eksportit (tarifa 0%) dhe nuk ka kufizime tarifore apo jotarifore. Gjithashtu eksportet përfitojnë nga norma 0% e TVSH-së, që u mundëson atyre të kërkojnë rimbursimin e TVSH-së së paguar për inputet e përdorura në prodhimin e mallrave të eksportuara. Vazhdimisht janë ndjekur edhe skema përjashtimi apo rimbursimesh për akcizën e lendëve djegëse që përdoren në prodhimet bujqësore, peshkim apo procese industriale.

Politikat tregtare

Marrëveshjet tregtare dhe integrimi rajonal janë shtylla të rëndësishme të politikës tregtare të Shqipërisë, duke ofruar qasje preferenciale në tregjet kryesore dhe duke nxitur rritjen e eksportit. Shqipëria ka zbatuar me sukses angazhimet e saj sipas Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë[29], si dhe masave të integrimit tregtar në nivel rajonal.

Janë implementuar në mënyrë të sukseshme objektivat dhe masat e parashikuara në Planin e veprimit për Tregun e përbashkët europian 2020 – 2024[30] veçanërisht në lidhje me zbatimin e Protokollit Shtesë të CEFTA-s për Lehtësimin e Tregtisë dhe zbatimin e Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë, për të cilën 98% e angazhimeve raportohen si të zbatuara në fillim të vitit 2023[31].

Sipas OECD[32] performanca e Shqipërisë u përmirësua ndjeshëm në dimensionin e politikës tregtare, duke mbetur ndër ekonomitë me performancën më të mirë në rajonin e Ballkanit Perëndimor[33] me progres të dukshëm në fushat e politikave tregtare dhe tregtisë digjitale.

Figura 8. Rezultatet për Shqipërinë në të gjitha dimensionet e politikave të perspektivës së konkurrueshmërisë (2021 dhe 2024)

[29] WTO TFA – World Trade Organization Trade Facilitation Agreement
[30] The Central European Free Trade Agreement's (CEFTA) Action Plan for the Common Regional Market (CRM) 2020-24
[31] Trade Policy Review: Albania, https://www.wto.org/english/tratop_e/tpr_e/s449_e.pdf
[32] OECD Competitiveness Outlook 2024
[33] https://www.oecd.org/en/publications/western-balkans-competitiveness-outlook-2024-regional-profile_170b0e53-en.html

Figure 1. Scores for Albania across Competitiveness Outlook policy dimensions (2021 and 2024)



Gjithashtu Shqipëria renditet e para[34] krahasuar me vendet e rajonit për sa i përket efektivitetit të qeverisë në formulimin e politikave tregtare.

Figura 9.



[34] https://westernbalkans-competitiveness.oecd.org/dimensions/TRADE/

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë[35] (MTL) janë instrumente shumë të rëndësishme për integrimin ekonomik të Shqipërisë me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë. Ato synojnë të lehtësojnë shkëmbimet tregtare duke eleminuar tarifat doganore dhe barrierat jotarifore ndërmjet vendeve që janë pjesë e marrëveshjes dhe duke u dhënë mundësi produkteve shqiptare të kenë akses në një treg të gjërë pa paguar tarifat doganore të importit. Shqipëria është pjesë e disa marrëveshjeve si më poshtë:

- **Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në:** Kjo mbetet marrëveshja më e rëndësishme, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2009. MSA-ja ofron qasje të gjerë pa tarifa dhe pa kuota për shumicën e produkteve shqiptare në tregun e BE-së. Gjithashtu, ajo shërben si një kuadër për harmonizimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, një aspekt thelbësore për rritjen e konkurrueshmërisë dhe standardeve të eksportuesve.

- **Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006):** Kjo marrëveshje, e ratifikuar në vitin 2006, ka lehtësuar ndjeshëm tregtinë me vendet e Ballkanit Perëndimor. Vlera e tregtisë brenda CEFTA-s për Shqipërinë ka shënuar rritje, me eksporte drejt Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Nismat e reja si "Tregu i Përbashkët Rajonal 2.0[36]" brenda CEFTA synojnë lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë së mallrave, shërbimeve dhe lëvizjes së lirë të njerëzve dhe kapitalit.

- **Marrëveshje Bilaterale të Tregtisë së Lirë:** Shqipëria ka marrëveshje të ngjashme me Turqinë (e firmosur në 2008) dhe vendet e EFTA-s (Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra marrëveshja e firmosur në 2009). Gjithashtu pas procesit të BREXIT dhe daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE Shqipëria ka lidhur Marrëveshjen e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë hyrë në fuqi më 3 maj 2021. Këto marrëveshje zgjerojnë mundësitë e tregut përtej BE-së dhe rajonit, por vëllimi i tregtisë me këto vende mbetet relativisht i ulët në krahasim me BE-në dhe vendet e CEFTA.
- **Konventa Pan- Euro-Mesdhetare e rregullave të Origjinës Preferenciale**[37] është një Konventë mjaft e rëndësishme në lidhje me rregullat e origjinës e cila paraqet rregullat që duhet të plotësojnë mallrat për të fituar statusin e origjinës në një vend të caktuar si dhe mundëson zbatimin e kumulimit të origjinës së mallrave ndërmjet vendeve partnere në këtë Konventë. Për të zbatur rregullat e origjinës dhe kumulimin e origjinës bazuar në rregullat e origjinës preferenciale pan-Euro-Mesdhetare, protokollet e origjinës në marrëveshjet e tregtisë së lirë në fuqi janë zëvëndësuar me rregullat e origjinës të kësaj Konvente. Më 7 dhjetor 2023, komiteti i Përbashkët i Konventës PEM miratoi një grup të ri rregullash origjine të zbatueshme që nga 1 janari 2025[38].
- **Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave** (GSP)[39] është një sistem asimetrik preferencash, sipas të cilit disa shtete si: Australia, Japonia, Norvegjia, Zvicra, Zelanda e Re, SHBA-ja, u japin preferencë mallrave të origjinës të eksportuara nga vendet në zhvillim, por jo anasjelltas. Skemat e GSP dhe rregullat e tyre të origjinës të ofruara nga vendet donatore janë të ndryshme. Vendet në të cilat mallrat me origjinë preferenciale shqiptare mund të eksportohen duke përfituar trajtim

[35] https://www.dogana.gov.al/d/182/249/0/263/marreveshjet-e-tregtise-se-lire
[36] CRM 2.0
[37] https://www.dogana.gov.al/d/182/249/0/264/konventa-pan-euro-mesdhetare-e-rregullave-te-origjines-preferenciale
[38] Miratuar me Ligjin 59/2024
[39] https://www.dogana.gov.al/d/182/249/0/230/spp-sistemi-i-pergjithshem-i-preferencave

tarifor preferencial sipas GSP janë: Australia, Japonia, Zelanda e Re, SHBA-ja.

Procedurat

Shqipëria, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare[40], me Kodin Doganor[41], dhe praktikat ndërkombëtare të tregtisë, zbatojnë një sërë regjimesh doganore që lehtësojnë operatorët ekonomikë duke u mundësuar atyre të ulin kostot dhe të konkurrojnë më lehtësisht në tregjet ndërkombëtare, duke përfituar nga lehtësira fiskale dhe procedurale.

Regjimet doganore të përdorura në një masë mjaft të madhe janë : regjimi i përpunimi aktiv dhe ai i përpunimit pasiv, regjimi i lejimit të përkohshëm, regjimi i transitit, magazinat doganore dhe zonat e lira ekonomike.

Gjithashtu legjislacioni doganor është i plotë sa i takon vendimeve të favorshme[42] sic janë informacioni detyrues i tarifës dhe informacioni detyrues i origjinës.

Gjatë formaliteteve doganore përdoret analiza e riskut në kontrolle, përdoren procedura dhe deklarata doganore të thjeshtuara, lehtësi si zhdoganimi lokal dhe ai i centralizuar, përfaqësimi i drejtpërdrejtë, eksportuesi i miratuar etj.

Operatori Ekonomik i Autorizuar (OEA[43]) është një status i cili i jepet kompanive që plotesojnë standardet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin doganor e që u jep kompanive lehtësira në formalitetet dhe kontrollet doganore, akses në procedura të thjeshtuara dhe trajtim preferencial në eksport-import. Me njohjen e ndërsjelltë që po i behet statusit të OEA (me vendet e rajonit e më vonë me vendet e BE) koha e kalimit në kufi do të reduktohet ndjeshëm.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për lehtësimin e tregtisë duke digjitalizuar[44] një sërë shërbimesh, duke filluar nga përdorimi i një sistemi të avancuar të deklarimit në doganë, nënshkrimi elektronik, pagesa elektronike e detyrimeve doganore duke modernizuar dhe lehtësuar kështu procedurat e saj administrative dhe tregtare.

Figura 10.

[40] Si WTO TFA (Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë në kuadër të OBT-së)
[41] Ligji 102/2014
[42] Ose advance ruling
[43] Ose AEO (Authorized Economic Operator) sic përdoret gjërësisht në terminologjinë doganore ndërkombëtare
[44] https://westernbalkans-competitiveness.oecd.org/dimensions/TRADE/



Si pasojë e këtyre zhvillimeve Shqipëria tani ka kohën e zhdoganimit më të shpejtë për importet dhe eksportet në rajon[45].

Në zhvillim e sipër janë sisteme të tilla si:

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifës (ITMS[46]) sipas versionit të BE-së në kuadër të Projektit të Binjakëzimit dy vjeçar IPA 2013 "Përgatitja e Administratës Doganore Shqiptare për Sistemin e Integruar të Menaxhimit Tarifor të Bashkimit Europian".

Sistemi i ri i Kompjuterizuar i Transitit (NCTS[47]) i cili bën të mundur ndërveprimin e Sistemit të Transitit me NCTS të BE-së, në kuadër të projekteve të Bankës Botërore (Western Balkans Trade and Transport Facilitation Project[48])

Dritarja e vetme (Single window) është një nga projektet që ka ndërmarrë qeveria në kuadër edhe të reformës së e-Qeverisjes, e mbështetur edhe nga Banka Botërore. Dritarja e vetme do të thjeshtojë procedurat e aplikimit online përmes një sporteli të vetëm në doganë, i cili do të lidhet me sistemet e institucioneve dhe agjencive të tjera qeveritare.

E-CMR: Në kuadër të AKR[49] parashikohet ratifikimi i Protokollit shtesë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave mbi "fletëshoqërimin elektronik" (e- CMR) për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (RI[50] 1.1.5)

---

[45] https://www.oecd.org/en/publications/western-balkans-competitiveness-outlook-2024-regional-profile_170b0e53-en.html
[46] ITMS – Integrated Tariff Management System
[47] New Computerized Transit System
[48] https://thedocs.worldbank.org/en/doc/156951590681038321-0090022020/original/WesternBalkans.pdf
[49] Agjenda Kombëtare e Reformave
[50] Reforma Indikative

6.2 Asistenca ndërkombëtare

Mbështetja nga donatorët ndërkombëtarë është thelbësore për zhvillimin e sektorit të eksportit në Shqipëri, duke ofruar financim, ekspertizë teknike dhe duke lehtësuar integrimin në tregjet globale. Partnerët ndërkombëtarë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e sektorit të eksportit.

Bashkimi Europian është partneri më i rëndësishëm i Shqipërisë, duke e konsideruar anëtarësimin në BE një objektiv strategjik themelor. Plani i Rritjes i BE-së për Ballkanin Perëndimor është një nismë transformuese, e cila synon të përshpejtojë konvergjencën socio-ekonomike të rajonit me BE-në dhe të hapë rrugën drejt anëtarësimit.[39]

Përveç Planit të Rritjes, BE ofron mbështetje përmes programeve të tjera si psh grantet për financim të programit Go Digital të BERZH për NVM-të, programit "Të Rinjtë në Biznes" të BERZH përmes Fondit Europian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus (EFSD+) etj.

Banka Botërore mbështet Shqipërinë në përpjekjet e saj për të krijuar më shumë vende pune të reja, për të forcuar kapitalin njerëzor dhe për të rritur rezistencën ndaj goditjeve, duke u udhëhequr nga Kuadri i Partneritetit të Vendit (CPF).[2]

Banka Botërore siguron kredi me interes zero ose të ulët, dhe grante për vendet në zhvillim për një gamë të gjerë sektorësh, përfshirë zhvillimin e sektorit financiar dhe privat.[2]

Mbështetja themelore e Bankës Botërore për infrastrukturën tregtare dhe qeverisjen është thelbësore. Megjithëse Banka Botërore nuk financon drejtpërdrejt bizneset individuale të eksportit, mbështetja e saj për Dritaren Kombëtare Unike[17] dhe Programin GovTech[2] është themelore. Këto nisma përmirësojnë efikasitetin e doganave, prokurimit publik dhe shërbimeve të përgjithshme qeveritare të cilat i shërbejnë biznesit. Programet e Bankës Botërore krijojnë një mjedis më të favorshëm operativ për të gjitha bizneset, përfshirë eksportuesit, duke reduktuar pengesat burokratike dhe duke rritur transparencën, të cilat janë kritike për tërheqjen e investimeve dhe lehtësimin e tregtisë.

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është një nga donatorët më aktivë në Shqipëri dhe ka në fokus zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat, komercializimin e projekteve të infrastrukturës, energjinë e qëndrueshme, investimet miqësore me mjedisin, përmirësimin e qeverisjes, konkurrencën e sektorit privat, qasjen në financim dhe aftësi, si dhe diversifikimin e energjisë dhe tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët.

BERZH ndër të tjera mbështet Forumin e Investimeve të Dhomave të Tregtisë të Ballkanit Perëndimor 6, Këshillin e Investimeve, mbështet dialogun politik për të reduktuar mospërputhjen e aftësive dhe për të rritur kapitalin njerëzor, si dhe ofron shërbime këshillimore për bizneset (ASB) për të ndihmuar bizneset e vogla të rriten.

Qasja e BERZH është e lidhur ngushtë me standardet e BE-së dhe tranzicionin e gjelbër. Kjo mbështetje e BERZH nuk ka të bëjë vetëm me rritjen e përgjithshme, por me përgatitjen e bizneseve shqiptare për kërkesat dhe mundësitë specifike të tregut të BE-së, duke përfshirë agjendën e gjelbër duke krijuar një avantazh konkurrues për eksportuesit shqiptarë.

GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) është një aktor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, duke operuar në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Bashkimit Europian. Fushat kryesore të punës së GIZ në Shqipëri përfshijnë zhvillimin ekonomik, trajnimin dhe punësimin, klimën dhe energjinë, si dhe qeverisjen e mirë. Në kuadër të këtyre fushave, GIZ promovon rritjen e tregtisë së jashtme në rajon. GIZ ka mbështetur harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis të BE-së në

një sërë kapitujsh, mbështet aftësitë e gjelbra dhe digjitale në arsim dhe promovon punësimin, tregtinë dhe investimet.

GIZ gjithashtu ndihmon kompanitë të zgjerojnë aftësitë dhe të zhvillojnë modele inovative, veçanërisht në bujqësi dhe turizmin rural, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave dhe tërheqjen e rajoneve rurale. Për më tepër, GIZ zbaton agjendën e reformave për tregtinë dhe konkurrencën në Europën Juglindore.

Fokusi i GIZ në harmonizimin e legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis të BE-së është kritik për strategjinë afatgjatë të eksportit të Shqipërisë duke ndërtuar kapacitete institucionale për të menaxhuar dhe negociuar politikat tregtare në mënyrë efektive. Puna e GIZ është thelbësore për të krijuar një mjedis rregullator të fortë dhe të parashikueshëm që është tërheqës si për investitorët vendas ashtu edhe për ata të huaj, dhe thelbësor për tregtinë me BE-në.

Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe **Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC),** ndërveprojnë për të përcaktuar dhe zbatuar programin e bashkëpunimit zviceran në Shqipëri. Fokusi i SECO, është në disa fusha duke filluar nga krijimi i një "kornize makroekonomike të besueshme" dhe një "mjedisi biznesi miqësor ndaj inovacionit" çka tregon se promovimi i drejtpërdrejtë i eksportit është më efektiv kur mbështetet në baza të forta. Kjo përfshin forcimin e tregjeve financiare, të drejtave të pronësisë intelektuale dhe përafrimin e raportimit të koorporatave me standardet ndërkombëtare. Kjo lloj mbështetjeje sistematike është thelbësor për konkurrencën afatgjatë të eksportit, pasi redukton risqet operacionale dhe rrit besimin e investitorëve, duke i mundësuar bizneseve, të zgjerohen dhe të angazhohen më efektivisht në tregtinë ndërkombëtare.

Programi Zviceran i Promovimit të Importit (SIPPO) i mbështetur nga Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) ka si objektivi të përgjithshëm integrimin e vendeve në zhvillim dhe në tranzicion në tregtinë botërore.

SIPPO këshillon dhe mbështet Organizatat Mbështetëse të Biznesit (BSO) në 12 vende partnere, përfshirë Shqipërinë, për të forcuar kapacitetet e eksportit dhe për të lehtësuar qasjen në tregjet e Zvicrës, BE-së dhe tregjet rajonale. SIPPO forcon kapacitetet e BSO-ve në tre fusha: përmirësimin e shërbimeve të promovimit të eksportit (inteligjenca e tregut, pjesëmarrja në panaire, misionet tregtare) dhe forcimin institucional (planifikimi strategjik, menaxhimi i ciklit të projektit, shkëmbimi i njohurive).

Ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshme përmes BSO-ve është një veçori dalluese e SIPPO. Strategjia e SIPPO-s për të mbështetur Organizatat Mbështetëse të Biznesit (BSO) është thelbësore pasi, në vend të ndihmës së drejtpërdrejtë afatshkurtër për kompanitë, ajo ndërton kapacitetin afatgjatë të institucioneve lokale për të ofruar shërbime të promovimit të eksportit. Kjo përfshin inteligjencën e tregut, pjesëmarrjen në panaire tregtare dhe zhvillimin institucional. Kjo qasje siguron që përpjekjet e promovimit të eksportit të jenë në pronësi lokale dhe të qëndrueshme përtej kohëzgjatjes së projektit, duke krijuar një sistem mbështetës më rezistent për eksportuesit shqiptarë.

USAID ka qenë një partner afatgjatë në zhvillimin e Shqipërisë, duke ofruar asistencë të rëndësishme financiare që nga fillimi i viteve 1990, përfshirë zhvillimin ekonomik. Puna e USAID në Shqipëri ka përfshirë sektorë si shëndetësia, arsimi, media dhe reformat në drejtësi.

Megjithatë, një zhvillim i fundit ka ndikuar ndjeshëm në programet e USAID. Në fund të Janarit 2025, administrata e SHBA-së lëshoi një urdhër ekzekutiv për të ngrirë financimet e reja për pothuajse të gjitha programet e asistencës ndërkombëtare të SHBA-së, duke prekur edhe Shqipërinë.

Kjo ngrirje çoi në ndërprerjen e shumë programeve edhe në Shqipëri[66]. Ajo nxorri pah ndjeshmërinë

e programeve të zhvillimit të varura nga ndihma ndaj ndryshimeve gjeopolitike dhe politikave të brendshme në vendet donatore dhe nënvizon nevojën që Shqipëria të diversifikojë bazën e saj të donatorëve dhe të forcojë kapacitetet e veta institucionale dhe financiare për të siguruar vazhdimësinë e programeve thelbësore të zhvillimit, veçanërisht atyre që mbështesin rritjen ekonomike dhe eksportin.

6.3 Sinergjitë, sfidat dhe rekomandimet

Analiza e institucioneve qeveritare dhe programeve të donatorëve ndërkombëtarë paraqet një ekosistem kompleks mbështetjeje për eksportet Shqiptare. Për të arritur një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të eksportit, është thelbësore të kuptohen sinergjitë ekzistuese, të adresohen sfidat dhe të formulohen rekomandime strategjike.

Sinergjitë dhe bashkëpunimi midis qeverisë dhe donatorëve. Ekziston një bashkëpunim i konsiderueshëm midis institucioneve qeveritare shqiptare dhe donatorëve ndërkombëtarë, veçanërisht në fushat e zhvillimit të NVM-ve, lehtësimit të tregtisë dhe përafrimit me BE-në. AIDA bashkëpunon me BERZH-in në mbështetjen e NVM-ve, dhe është partner me ITC dhe SIPPO për pjesëmarrjen e kompanive shqiptare në panaire ndërkombëtare. BERZH dhe BE po nxisin bizneset e vogla duke mbështetur programe si Go Digital dhe Të Rinjtë në Biznes. BERZH mbështet këshillat e investimeve dhe dhomat e tregtisë, përfshirë Forumin e Investimeve të Dhomave të Tregtisë të Ballkanit Perëndimor 6. GIZ siguron një koordinim të mbështetjes gjermane dhe europiane dhe mbështet institucionet dhe bizneset shqiptare. Projektet e Bankës Botërore, si ai i Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit, synojnë reduktimin e barrierave tregtare. Plani i Rritjes i BE-së kërkon që Shqipëria të zbatojë reforma në Agjendën e saj të Reformave për të zhbllokuar pagesat, duke nxitur një bashkëpunim të ngushtë midis Komisionit Europian dhe Qeverisë Shqiptare.

Edhe me një vëzhgim sipërfaqsor mund të vihet re një përqendrim i përpjekjeve të donatorëve për të ndihmuar Shqipërinë drejt integrimit në BE. Tema e përsëritur midis donatorët kryesorë (BE, BERZH, GIZ, SECO) është përafrimi i programeve të tyre me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe forcimin e sektorit të saj privat për të konkurruar në tregun unik europian. Kjo tregon një përpjekje të koordinuar ndërkombëtare për të mbështetur objektivin strategjik të Shqipërisë. Ky përafrim ofron një drejtim të qartë për bizneset shqiptare për të fokusuar përpjekjet e tyre në përmbushjen e standardeve të BE-së dhe integrimin në zinxhirët e vlerës europiane, duke ditur se sistemet mbështetëse, si vendase ashtu edhe ndërkombëtare, janë të orientuara drejt këtij qëllimi.

7. Vështrim i detajuar mbi sektorët kryesorë të eksportit

7.1. Eksportet e mallrave: sektorët kryesorë dhe situata e detajuar

7.1.1 Ushqim & Pije

Situata aktuale: Sektori i ushqimit dhe pijeve është një ndër më të rëndësishmit në industrinë përpunuese shqiptare, i lidhur ngushtë me prodhimin bujqësor vendas dhe trashëgiminë gastronomike. Ai përfshin një gamë të gjerë produktesh me potencial për eksport, si: vera, vaji i ullirit, produktet e qumështit, konservat dhe pijet tradicionale. Disa prej kompanive arrijnë të përmbushin kërkesat për ambalazhim, etiketim dhe siguri ushqimore, duke qenë të afta të konkurrojnë në tregje të huaja.

Sfidat: Sektori perballet me sfida të shumta që kufizojnë zhvillimin e eksportit në këtë sektor. Mungesa

e mbështetjes teknike për t'iu përafruar standardeve ndërkombëtare dhe mungesa e rrjetëzimit me agjentë tregtarë në vendet e huaja pengojnë hyrjen në tregje të reja. Procedurat burokratike, dokumenta në letër dhe certifikatat që nuk njihen jashtë vendit rrisin kostot dhe vonesat në eksport. Po ashtu, qasja në financim mbetet e kufizuar për shkak të kushteve të pafavorshme bankare dhe mungesës së instrumenteve të dedikuara. Mungesa e laboratorëve të certifikuar dhe bashkëpunimit me universitetet kufizon aftësinë për të përmbushur kërkesat teknike të tregjeve.

Potenciali: Pavarësisht këtyre sfidave, sektori paraqet një potencial të madh për rritje, veçanërisht nëse mbështetet me politika të synuara për standardizim, promovim tregtar dhe akses në financim. Krijimi i laboratorëve të akredituar, forcimi i lidhjes me universitetet dhe përfshirja në rrjete ndërkombëtare përfaqësimi, do të ishin hapa kyç drejt zgjerimit të pranisë së produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

7.1.2. Materialet e Ndërtimit

Situata aktuale: Sektori i materialeve të ndërtimit është një nga sektorët më të zhvilluar të industrisë prodhuese në Shqipëri, me potencial të lartë për eksport falë burimeve natyrore të bollshme dhe kapaciteteve të konsoliduara prodhuese në prodhimin e çimentos, tullave, gurëve dekorativë, pllakave, dhe materialeve të tjera. Prodhimet shqiptare janë të pranishme në disa tregje rajonale dhe europiane, megjithatë, mungesa e një strategjie të strukturuar për promovimin dhe mbështetjen e eksportit pengon shfrytëzimin e plotë të këtij potenciali.

Sfidat: Sektori i materialeve të ndërtimit përballet me një sërë sfidash që pengojnë zhvillimin e tij eksportues. Mungesa e një marke kombëtare të certifikuar "Made in Albania" kufizon ndërtimin e imazhit dhe diferencimin në tregjet ndërkombëtare. Bizneset raportuan gjithashtu trajtim të pabarabartë fiskal, ku aplikimi i akcizës për lëndët djegëse rrit kostot dhe ul konkurrueshmërinë ndaj produkteve të importuara. Luhatjet e kursit të këmbimit përbëjnë një tjetër rrezik, për të cilin mungojnë instrumente mbrojtëse. Së fundmi, aksesimi i financimit mbetet i kufizuar për shkak të interesave të larta, kërkesave për kolateral dhe mungesës së produkteve të dedikuara për eksportuesit.

Potenciali: Sektori ka potencial të konsiderueshëm për të zgjeruar praninë në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht nëse mbështetet me politika të qarta, rishikim të trajtimit fiskal, instrumente për mbrojtje valutore dhe akses të lehtësuar në financim. Promovimi i produkteve përmes një marke unike "Made in Albania", bashkëpunimi me bankat për zhvillimin e produkteve të dedikuara për eksport dhe mbështetja për investime të qëndrueshme do të rrisnin dukshëm konkurrueshmërinë dhe besueshmërinë e këtij sektori.

7.1.3. Tekstile & Lekurë

Situata aktuale: Ky sektor ka qenë vazhdimisht shtylla e eksporteve të mallrave shqiptare, duke operuar kryesisht në modelin fason për markat italiane dhe europiane të tjera. Ndërsa përfiton nga kostot konkurruese të punës dhe afërsia gjeografike me tregjet kryesore të BE-së, bizneset përballen me sfida nga konkurrenca në rritje nga prodhuesit me kosto më të ulët dhe nevoja për të kaluar në prodhimin me markën e tyre dhe akses të drejtpërdrejtë në tregjet ndërkombëtare. Të dhënat e fundit sugjerojnë një rimëkëmbje të kërkesës për eksport pas një rënieje të mëparshme.

Sfidat: Sektori perballet me disa sfida kryesore që kufizojnë potencialin eksportues. Mungesa e një enti certifikues kombëtar për CE dhe varësia nga institucionet e huaja për certifikime sjellin kosto të

larta dhe vonesa në aksesin në tregjet e BE-së. Bizneset gjithashtu përballen me vështirësi në gjetjen e agjentëve tregtarë dhe partnerëve për promovim ndërkombëtar, për shkak të mungesës së rrjeteve dhe informacionit të strukturuar.
Një tjetër pengesë është mungesa e aksesit në modele dhe tendenca globale, që kufizon aftësinë e kompanive për të përshtatur ofertën sipas kërkesave të tregut. Nga ana tjetër, mungesa e instrumenteve financiare të përshtatura për sektorin përbën një sfidë madhore. Kjo përfshin mungesën e skemave për financimin e lëndëve të para, investimeve në teknologji, aktiviteteve promocionale ndërkombëtare dhe sistemet ERP për menaxhim të integruar.
Likuiditeti i kufizuar, ciklet intensive të prodhimit dhe mungesa e mbështetjes për digjitalizim pengojnë rritjen e qëndrueshme. Gjithashtu, u theksua nevoja për forcimin e strukturave institucionale që mbështesin eksportin, përfshirë krijimin e një agjencie të dedikuar për promovimin e eksporteve, që do të koordinojë politikat kombëtare, asistencën teknike dhe pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare.

Potenciali: Sektori i tekstileve dhe lëkurës ka potencial të lartë për të kaluar nga modeli fason drejt prodhimit me markë dhe vlerë të shtuar. Afërsia me tregjet e BE-së, kosto konkurruese dhe kapacitetet ekzistuese prodhuese përbëjnë avantazhe të rëndësishme. Me mbështetje për certifikim, financim dhe promovim ndërkombëtar, sektori mund të rrisë ndjeshëm eksportet dhe të krijojë punësim të qëndrueshëm.

7.1.4. Metalet

Situata: Sektori i metaleve në Shqipëri përfshin industri prodhuese dhe përpunuese me kapacitete të konsoliduara dhe një histori të gjatë në tregun vendas dhe atë rajonal. Produktet e tij përfshijnë pajisje ndërtimi, konstruksione metalike, përpunim çeliku dhe produkte të specializuara për industri të ndryshme. Potenciali për eksport është i lartë, por kërkon mbështetje të qëndrueshme në fushat e standardizimit, modernizimit teknologjik dhe lehtësimit të barrierave tregtare.

Sfidat: Sektori i metaleve përballet me sfida të shumta që kufizojnë aftësinë e tij eksportuese. Informimi dhe njohja e legjislacionit nga ana e bizneseve pengojnë përputhjen me kërkesat teknike të tregjeve ndërkombëtare. Bizneset raportuan vështirësi në gjetjen e partnerëve tregtarë jashtë vendit, për shkak të mungesës së rrjeteve dhe mbështetjes institucionale.
Problemet në klasifikimin doganor sjellin vonesa dhe kosto shtesë, ndërsa mungesa e zbatimit të skanimit sipas riskut në dogana ndikon negativisht në logjistikën dhe afatet e eksportit. Luhatjet e kursit të këmbimit rrisin pasigurinë financiare, ndërkohë që mungojnë instrumentet për menaxhimin e këtij rreziku. Po ashtu, sektorit i mungon mbështetja për investime në teknologji dhe automatizim. U theksua edhe nevoja për institucione më efikase dhe për një agjenci të dedikuar për eksportet, si dhe për forcimin e shoqatave të sektorit.

Potenciali: Sektori i metaleve ka potencial të konsiderueshëm për rritje të qëndrueshme dhe zgjerim në tregjet ndërkombëtare, sidomos nëse mbështetet përmes standardizimit, përmirësimit teknologjik, zhvillimit të rrjeteve tregtare dhe forcimit të institucioneve mbështetëse. Një qasje e integruar dhe e koordinuar ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat do të jetë kyçe për rritjen e eksportit dhe ndërtimin e një industrie të fortë dhe konkurruese në nivel rajonal dhe europian.

7.2. Eksportet e shërbimeve: Sektorët kryesorë dhe situata e detajuar

7.2.1. Turizmi

Situata: Turizmi po konsolidohet si një nga sektorët më të rëndësishëm të eksporteve të shërbimeve në Shqipëri, duke gjeneruar mbi 40% të eksporteve totale dhe mbi 60% të eksporteve të shërbimeve. Rritja e numrit të vizitorëve ndërkombëtarë, bregdeti i pasur, trashëgimia kulturore dhe çmimet konkurruese e kanë kthyer Shqipërinë në një destinacion tërheqës në Evropë. Investimet në infrastrukturë, si aeroporti i ri i Vlorës, pritet të nxisin më tej segmentin e turizmit elitar dhe të diversifikuar.

Sfidat: Në sektorin e turizimit evidentohen një sërë sfidash që kufizojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të turizmit. Një ndër problemet kryesore është përdorimi i materialeve promovuese jo të standardizuara, që shpesh përçojnë informacion të pasaktë dhe krijojnë pritshmëri të rreme tek turistët, duke dëmtuar imazhin e destinacionit.
Investimet që nuk respektojnë karakterin lokal të zonave turistike, veçanërisht në fshatra dhe rajone natyrore, kanë çuar në cenimin e autenticitetit dhe uniformizimin e përvojës turistike. Kjo bie ndesh me trendin global të kërkesës për përvoja autentike dhe të qëndrueshme.
U theksua gjithashtu mospërputhja e TVSH-së mes hoteleve (6%) dhe operatorëve turistikë (20%), që krijon pabarazi fiskale dhe vështirëson ndërtimin e paketave konkurruese. Një tjetër sfidë është pasiguria që vjen nga luhatjet e kursit të këmbimit dhe vështirësitë në kryerjen e pagesave ndërkombëtare përmes sistemit bankar, që ndikojnë në likuiditet dhe planifikim financiar, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla.
Problemi i informalitetit mbetet gjithashtu i theksuar, me një pjesë të konsiderueshme të guidave dhe strukturave të akomodimit që operojnë jashtë rrjetit formal. Kjo dëmton konkurrencën e ndershme, cilësinë e shërbimit dhe vetë reputacionin e destinacionit në sytë e turistëve të huaj.

Potenciali: Turizmi shqiptar ka një potencial të madh për zgjerim dhe sofistikim, veçanërisht nëse zhvillohet përtej sezonit veror dhe përfshin rajone më pak të njohura. Promovimi i turizmit të qëndrueshëm, investimi në oferta të reja si agroturizmi, ekoturizmi dhe turizmi kulturor, si dhe tërheqja e markave ndërkombëtare të hotelerisë mund të rrisin ndjeshëm vlerën e këtij sektori. Mbështetja për marketing digjital dhe përmirësimi i koordinimit institucional do të jenë kyçe për një zhvillim të integruar dhe afatgjatë të turizmit shqiptar.

7.2.2. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Shërbimet e Proçesimit të Biznesit (BPO)

Situata: Sektori i TIK dhe BPO është një prej sektorëve me rritjen më të shpejtë në Shqipëri, i nxitur nga një fuqi punëtore e re, shumëgjuhëshe dhe kosto të ulëta operimi. Vendi po pozicionohet si një destinacion "nearshoring", sidomos për call centers, zhvillim softueri dhe shërbime mbështetëse. Politikat fiskale favorizuese dhe përqendrimi i industrisë në Tiranë po krijojnë një bazë të qëndrueshme për rritjen e eksporteve të shërbimeve TIK dhe BPO.

Sfidat: Mungesa e mbështetjes institucionale për hyrjen në tregje të reja dhe promovimin ndërkombëtar kufizon ekspozimin e kompanive shqiptare dhe pengon depërtimin në sektorë të specializuar. Po ashtu, mungon një qasje e qartë për përputhjen me standardet europiane të privatësisë së të dhënave (GDPR), çka krijon pasiguri në marrëdhëniet me partnerët ndërkombëtarë.
Një tjetër shqetësim i theksuar është informaliteti në tregun e punës, ku kompani të huaja punësojnë

staf shqiptar në mënyrë informale, duke krijuar konkurrencë të padrejtë dhe vështirësi në gjetjen e burimeve të kualifikuara për kompanitë vendase.
U theksua gjithashtu mungesa e burimeve njerëzore shumë të specializuara dhe sfida në mbajtjen e profesionistëve në vend, për shkak të *"largimit të trurit"* dhe ofertave konkurruese nga jashtë. Kjo ndikon në zhvillimin e shërbimeve me vlerë të shtuar të lartë dhe kufizon kapacitetet për të kaluar në fazën tjetër të sofistikimit teknologjik.

Potenciali: Sektori ka potencial të lartë për zhvillim drejt shërbimeve më komplekse si siguria kibernetike, inteligjenca artificiale dhe cloud computing. Ekspansioni drejt tregjeve përtej Italisë dhe ndërtimi i parqeve teknologjike dhe qendrave të inovacionit do të ndihmonte në rritjen e qëndrueshme të sektorit. Mbështetja për start-ups, forcimi i ekosistemit të inovacionit dhe nxitja e talenteve të reja janë kyçe për të kaluar nga shërbime rutinë në kapacitete me vlerë të shtuar.

7.3 Sektor horizontal - Digjitalizimi dhe inovacioni

Digjitalizimi dhe innovacioni janë trajtuar si një "sektor" më vete në këtë dokument duke patur parasysh se janë shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe social; ato janë pjesë integrale e çdo sektori në veçanti por edhe të lidhura ngushtë me politika dhe aktorë shtetërorë.

Shqipëria ka përjetuar një transformim të thellë në fushën e digjitalizimit dhe inovacionit gjatë viteve të fundit, kryesisht i nxitur nga **iniciativa qeveritare** të tilla si:

- **Platforma e-Albania** me mbi 95% të shërbimeve publike ofrohen online, e-Albania ka thjeshtuar ndjeshëm ndërveprimin e qytetarëve dhe bizneseve me administratën shtetërore. Kjo ka rezultuar në rritjen e efikasitetit, uljen e burokracisë dhe zvogëlimin e hapësirave për korrupsion.
- **Fiskalizimi**: Procesi i fiskalizimit, i cili hyri në fuqi në vitin 2021, ka modernizuar sistemin tatimor duke detyruar digjitalizimin e faturave dhe transaksioneve. Ky sistem, me gjithë sfidat fillestare të implementimit, ka synuar rritjen e transparencës fiskale dhe uljen e evazionit.
- **Infrastruktura e Internetit**: Aksesi në internet ka shënuar rritje. Megjithatë, përqendrimi i aksesit të shpejtë mbetet kryesisht në zonat urbane, ndërsa zonat rurale ende përballen me mungesë të infrastrukturës së përshtatshme.
- **Inovacioni**: Në Indeksin Evropian të Inovacionit (European Innovation Scoreboard) 2024, Shqipëria është klasifikuar si një "Inovator në Zhvillim" (Emerging Innovator), duke treguar një rritje të performancës në inovacion me 41.8% të mesatares së BE-së. Kjo rritje vlerësohet se ka ardhur kryesisht nga përmirësimet në sistemet kërkimore dhe digjitalizim.
- **Qendrat e Inovacionit Digjital (DIH)**: Shqipëria po synon të bëhet pjesë e Rrjetit Evropian të Qendrave të Inovacionit Digjital (European Digital Innovation Hubs), të cilat do të shërbejnë si pika kontakti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe sektorin publik për të aksesuar ekspertizën, trajnimin dhe mbështetjen për digjitalizimin. Në Prill 2024 Shqipëria ka inauguruar Qendrën Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë për Materialet e Papërpunuara[51] (EIT Raw Materials) në qytetin e Elbasanit. Ky është një hap i rëndësishëm dhe i pari i këtij lloji në Ballkanin Perëndimor, i cili synon të katalizojë inovacionin, arsimin dhe krijimin e biznesit në sektorin e materialeve të

[51] https://rawmaterialsalbania.al/en/index.php

papërpunuara në Shqipëri dhe rajon.

- **Gjithsesi sa i takon kuadrit ligjor dhe rregullator mbetet akoma për të bërë**: Ndërsa ka pasur progres (p.sh., Ligji Nr. 10273, datë 29.4.2010 "Për dokumentin elektronik dhe nënshkrimin elektronik**")**, mungojnë ende ligje të qarta dhe rregullore specifike për fusha të reja si inteligjenca artificiale, blockchain, dhe siguria e të dhënave.

Por ndërkohë që në aspektin e e-qeverisjes, Shqipëria renditet në vendet më të larta në rajon, në aftësitë e avancuara digjitale dhe përdorimin e teknologjisë nga bizneset Shqipëria shpeshherë pozicionohet në pjesën e poshtme të mesit ose fundore të renditjeve të përgjithshme ndërkombëtare për konkurrueshmërinë digjitale. Sektori privat tregon nivele të ndryshme të adoptimit të teknologjive digjitale.

- **Adoptimi i teknologjive**: Bizneset e mëdha, telekomunikacioni, bankat dhe bizneset e sektorit të TIK-ut janë më të avancuara në përdorimin e zgjidhjeve digjitale si ERP, CRM, cloud computing dhe e-commerce, ndërkohë që NVM (sidomos sektorët tradicionalë si bujqësia) shpesh përballen me vështirësi në këtë aspekt. Kostot e larta të investimit në teknologji, mungesa e ekspertizës digjitale dhe ndërgjegjësimi i ulët për përfitimet e digjitalizimit mbeten pengesa serioze për NVM-të.
- **Investimet në R&D (Kërkim dhe Zhvillim)**: Shqipëria ka investime relativisht të ulëta në R&D si përqindje e PBB-së, si nga sektori publik ashtu edhe ai privat, duke qenë ndjeshëm nën mesataren e BE-së. Kjo kufizon potencialin për zhvillimin e njohurive dhe teknologjive të reja.
- **Bashkëpunimi universitet-biznes dhe patentat**: Lidhjet midis universiteteve, instituteve kërkimore dhe industrisë janë të dobëta, duke penguar transferimin e njohurive dhe komercializimin e inovacionit. Numri i patentave të regjistruara në **Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM)** është i ulët, duke treguar një aktivitet të kufizuar inovativ në krahasim me vendet e tjera.
- **Ekosistemi i Start-up-eve** në Shqipëri është në fazat e hershme të zhvillimit, por me potencial në rritje. Ka një rritje të numrit të start-up-eve, veçanërisht në sektorin e TIK.
- **Qasja në financime është një sfidë madhore**. Mungojnë burimet e financimit si "angel investors" dhe "venture capital", duke bërë që start-ups të varen kryesisht nga fonde të vogla, grante nga donatorë ndërkombëtarë si **UNDP** apo **USAID**, ose vetë-financim.
- **Kultura e ndërgjegjësimit dhe adaptimit**: Ekziston një rezistencë ndaj ndryshimit dhe teknologjisë, si në administratën publike, ashtu edhe në një pjesë të sektorit privat dhe shoqërisë.

8. Analiza SWOT e Eksporteve Shqiptare

Kjo analizë SWOT gjithëpërfshirëse merr në konsideratë si eksportet e mallrave ashtu edhe të shërbimeve, duke theksuar aftësitë e brendshme dhe kushtet e tregut të jashtëm.

8.1. Pikat e Forta

- **Pozicioni gjeografik strategjik:** Afërsia e Shqipërisë me tregjet kryesore evropiane (veçanërisht Italia dhe Greqia) ofron një avantazh logjistik të rëndësishëm si për transportin e mallrave ashtu

edhe për mundësitë e "nearshoring"-ut për shërbimet (p.sh., ICT/BPO).

- **Burime natyrore të bollshme:** Depozita të pasura me krom, bakër dhe nikel, së bashku me potencial të konsiderueshëm hidroenergjetik, ofrojnë një bazë të fortë për eksportet e mallrave.
- **Sektor i turizmit me rritje të shpejtë:** Një burim kryesor dhe në zgjerim i eksporteve të shërbimeve, që tërheq një numër në rritje të vizitorëve ndërkombëtarë dhe nxit industritë e lidhura me shërbimet si hoteleria, transporti dhe agroturizmi.
- **Kosto konkurruese e punës:** Kostot relativisht më të ulëta të punës krahasuar me Evropën Perëndimore ofrojnë një avantazh të fortë konkurrues për industritë përpunuese me intensitet pune (tekstile, këpucë) dhe sektorët e shërbimeve (BPO, call centers).
- **Artizanat i kualifikuar:** Vendi ka krijuar një reputacion për artizanat cilësor, veçanërisht të dukshëm në sektorin e veshjeve.
- **Fuqi punëtore e re:** Një rezervë në rritje e profesionistëve të rinj, veçanërisht me njohuri të thella të italishtes dhe anglishtes, ofron një avantazh kyç për sektorin në lulëzim të TIK-ut dhe BPO-së.
- **Prospekti i anëtarësimit në BE:** Procesi i vazhdueshëm i anëtarësimit në BE ofron një kuadër për reforma, harmonizon standardet kombëtare me acquis të BE-së, lehtëson qasjen në fondet e para-anëtarësimit (IPA) dhe rrit besimin e investitorëve, duke thjeshtuar kështu tregtinë e mallrave dhe shërbimeve.
- **Lidhje të forta me diasporën:** Një diasporë e madhe dhe aktive shqiptare ofron burime potenciale investimi, lidhje tregu, transferim njohurish dhe sipërmarrje për bizneset e orientuara drejt eksportit.
- **Fokusi qeveritar në rritjen e eksporteve:** Qeveria aktuale ka prioritizuar në mënyrë eksplicite rritjen e eksporteve, dëshmuar nga objektiva ambicioze (p.sh., 1 miliard euro eksporte bujqësore) dhe prezantimi i skemave të reja të financimit.
- **Ekonomia digjitale në zhvillim:** Adoptimi në rritje i teknologjive digjitale dhe një ekosistem start-ups i sapolindur, por premtues, mbështesin inovacionin në eksportet e shërbimeve.
- **Fokus në rritje në praktikat etike dhe të qëndrueshme:** Ekziston një kërkesë globale në rritje për veshje me burime të qëndrueshme, një trend që përputhet mirë me kapacitetin e Shqipërisë për prodhim të vogël dhe të mesëm dhe theksin e saj në rritje në praktikat etike të prodhimit. Kjo mbështetet më tej nga iniciativa të tilla si metodologjia e UNIDO-s për Prodhim Efikas të Burimeve dhe Pastër (RECP) dhe "Udhërrëfyesi Zero Draft për OZH-të/Axhendën e Gjelbër të BE-së".
- **Marrëveshjet Tregtare:** MSA me BE-në dhe CEFTA ofrojnë qasje të gjerë në tregjet kryesore pa tarifa.

8.2. Dobësitë

- **Varësi e lartë nga lëndët e para të importuara**: Kjo dobësi është veçanërisht e theksuar në sektorin TCLF, ku mungesa e një infrastrukture të fuqishme të prodhimit vendas të tekstilit kërkon varësi të madhe nga pëlhurat e importuara. Kjo rrit drejtpërdrejt kostot e prodhimit dhe zgjat kohën e përgatitjes.
- **Përparim/Inovacion i kufizuar teknologjik:** shqipëria mbetet prapa në përvetësimin e teknologjisë së përparuar dhe automatizimit, veçanërisht brenda sektorëve të saj të prodhimit.

Investimet në kërkim dhe zhvillim (R&D) janë të ulëta dhe ka një mungesë të dukshme të rezultateve të inovacionit.

- **Mungesa të konsiderueshme të fuqisë punëtore dhe boshllëqe në aftësi:** Emigrimi masiv i punëtorëve si të kualifikuar ashtu edhe të pakualifikuar në Evropën Perëndimore, i nxitur nga joshja e pagave më të larta dhe mundësive më të mira, ka krijuar një mungesë akute të fuqisë punëtore në Shqipëri. Kjo përkeqësohet nga programet e kufizuara të trajnimit profesional, duke çuar në një mospërputhje të vazhdueshme midis aftësive të disponueshme dhe kërkesave të industrisë.
- **Prodhim me vlerë të shtuar të ulët:** Një dobësi kryesore si te mallrat (p.sh., prodhimi "fason", eksporti i lëndëve të para) ashtu edhe te shërbimet (p.sh., operacionet bazë të call center-ave) kufizon marzhet e fitimit, inovacionin dhe rritjen ekonomike afatgjatë.
- **Infrastrukturë e pamjaftueshme:** Pavarësisht se përmirësimet janë të dukshme, boshllëqet në infrastrukturën e transportit (veçanërisht rrjeti hekurudhor), stabilitetin e furnizimit me energji (varësia nga hidrocentralet) dhe infrastrukturën digjitale të avancuar (broadband në zonat rurale, qendrat e të dhënave) mund të pengojnë logjistikën efikase të eksportit dhe besueshmërinë e sektorit të shërbimeve.
- **Qasje e kufizuar në financim për NVM-të:** Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) shpesh përballen me sfida në qasjen në kredi dhe investime të përballueshme për modernizim, zgjerim të kapaciteteve dhe hyrje në treg, duke penguar rritjen e eksportit.
- **Diversifikim i kufizuar i eksporteve dhe përqendrim i tregut:** Eksportet e Shqipërisë janë shumë të përqendruara, me një varësi dërrmuese nga Italia si destinacioni kryesor. Vendi zotëron shportën më pak të diversifikuar të eksporteve krahasuar me homologët e tij rajonalë.
- **Ndjeshmëria ndaj goditjeve të jashtme:** Kombinimi i tregjeve të përqendruara të eksportit dhe mbështetja në sektorët me vlerë të ulët të shtuar e bën ekonominë shqiptare shumë të ndjeshme ndaj rënieve ekonomike ose ndryshimeve të politikave në partnerët e saj kryesorë tregtarë.
- **Burokracia dhe barra administrative:** Procedurat administrative komplekse, të gjata dhe ndonjëherë të paqarta mund të jenë një pengesë e rëndësishme për bizneset, veçanërisht për eksportuesit e rinj dhe ata që veprojnë në tregtinë ndërkufitare.
- **Mungesa e teknologjisë moderne dhe aftësive të specializuara:** Investimi i pamjaftueshëm në makineri moderne dhe mungesa e fuqisë punëtore me aftësi shumë të specializuara (p.sh., në TIK të avancuar, inxhinieri komplekse) kufizojnë produktivitetin dhe konkurrueshmërinë në sektorë të caktuar.
- **Sezonaliteti i lartë në turizëm:** Mbivarësia nga muajt kulminantë të verës për turizmin çon në kapacitete të pashfrytëzuara dhe paqëndrueshmëri të punësimit jashtë sezonit.
- **Copëzimi i tokës në bujqësi:** Pronat e vogla dhe të copëtuara të tokës pengojnë prodhimin bujqësor në shkallë të gjerë dhe efikas, si dhe adoptimin e praktikave moderne të bujqësisë.
- **Njohja e kufizuar e markës:** Shumë produkte dhe ofrues shërbimesh shqiptarë nuk kanë një njohje të fortë të markës ndërkombëtare, duke e bërë të vështirë arritjen e çmimeve premium dhe ndërtimin e besnikërisë së klientëve.

8.3. Mundësitë

- **Kërkesa në rritje në tregun e BE-së:** Perspektiva e anëtarësimit në BE ofron qasje të gjerë në një nga tregjet më të mëdha dhe më të pasura në botë, duke nxitur ndjeshëm kërkesën për mallra dhe shërbime shqiptare.
- **Trendet e "Nearshoring" dhe "Friendshoring":** Çrregullimet në zinxhirët globalë të furnizimit dhe ndryshimet gjeopolitike po shtyjnë kompanitë të zhvendosin prodhimin dhe ofrimin e shërbimeve më afër vendit të origjinës, duke paraqitur një mundësi të rëndësishme për Shqipërinë si në prodhim ashtu edhe në shërbime (TIK/BPO).
- **Rritja e kërkesës globale për mallra të qëndrueshme dhe të prodhuara në mënyrë etike**: Ndërgjegjësimi në rritje midis konsumatorëve dhe markave për mallra të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe etike përputhet mirë me kapacitetin e Shqipërisë për prodhim të vogël dhe të mesëm dhe fokusin e saj në rritje në praktikat etike. Kjo paraqet një mundësi të rëndësishme për të diferencuar eksportet e saj dhe për të aksesuar tregjet premium.
- **Rritja e Investimeve të Huaja Direkte (IHD):** Tërheqja e IHD-ve më të diversifikuara mund të sjellë jo vetëm kapital, por edhe teknologji kritike, ekspertizë menaxheriale dhe qasje në tregje të reja ndërkombëtare për sektorët e orientuar drejt eksportit.
- **Zhvillimi i bujqësisë dhe agropërpunimit me vlerë të lartë:** Kërkesa globale për produkte bujqësore organike, të specializuara dhe të përpunuara ofron një rrugë për Shqipërinë për të rritur të ardhurat nga eksporti përmes modernizimit dhe vlerës së shtuar.
- **Procesi i integrimit në BE:** Progresi i vazhdueshëm i Shqipërisë drejt integrimit në BE ofron një shtysë të fuqishme për reformat strukturore, duke kërkuar përafrimin me standardet e BE-së, duke përfshirë Tregun e Përbashkët për Produktet e Gjelbra. Ky proces hap rrugë për shtim më të madh të vlerës dhe akses të zgjeruar në treg brenda Bashkimit Evropian.
- **Aksesi në fonde të BE-së**, veçanërisht në kuadër të Politikës së Përbashkët Bujqësore (CAP[52]), ofron mundësi të rëndësishme për modernizim dhe rritje të produktivitetit. Prodhuesit shqiptarë mund të rrisin eksportet drejt BE-së, veçanërisht për perimet e hershme, bimët mjekësore dhe ushqimet e specializuara me vlerë të lartë, duke u fokusuar në tregjet e veçanta dhe duke siguruar pajtueshmërinë me standardet e gjurmueshmërisë dhe sigurisë ushqimore të BE-së.
- **Zgjerimi i energjisë së rinovueshme:** Zhvillimi i mëtejshëm i energjisë diellore dhe të erës mund të rrisë eksportet e qëndrueshme të energjisë elektrike dhe të zvogëlojë varësinë nga hidrocentralet, duke rritur sigurinë energjetike dhe kapacitetin eksportues.
- **Përshpejtimi i digjitalizimit dhe e-commerce:** Rritja e shpejtë globale e e-commerce dhe platformave digjitale të ofrimit të shërbimeve i lejon bizneseve shqiptare të arrijnë tregje të reja dhe të thjeshtojnë proceset e eksportit në mënyrë më efikase.
- **Forcimi i tregtisë rajonale (Ballkani Perëndimor):** Thellimi i integrimit ekonomik dhe përmirësimi i lehtësimit të tregtisë brenda Ballkanit Perëndimor (p.sh., nismat e Tregut të Përbashkët Rajonal) mund të krijojë mundësi të reja tregu dhe të forcojë zinxhirët e furnizimit rajonal.
- **Shfrytëzimi i diasporës për zhvillim:** Diaspora shqiptare përfaqëson një burim të rëndësishëm njohurish, aftësish dhe kapitali ekonomik. Angazhimi i kësaj diaspore mund të kontribuojë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik, duke përfshirë nxitjen e investimeve të reja dhe lehtësimin e transferimit të njohurive.

---

[52] Common Agriculture Policy

- **Tregjet niche:** Identifikimi dhe zhvillimi i tregjeve niche për produkte unike shqiptare (p.sh., bimë mjekësore specifike, artizanat) dhe shërbime të specializuara (p.sh., turizëm aventurash, zgjidhje specifike TIK).
- **Turizmi mjekësor:** Shfrytëzimi i kostove konkurruese të kujdesit shëndetësor dhe burimeve natyrore (p.sh., burimet termale) për të zhvilluar një sektor të ri të turizmit mjekësor.

8.4. Kërcënimet

- **Rënie ekonomike globale:** Goditjet ekonomike të jashtme, si recesionet në partnerët kryesorë tregtarë, konfliktet gjeopolitike ose inflacioni në rritje, mund të ndikojnë ndjeshëm në kërkesën për eksportet shqiptare (si mallra ashtu edhe shërbime).
- **Konkurrencë e intensifikuar globale dhe rajonale:** Ndërsa Shqipëria integrohet më tej, eksportuesit e saj përballen me konkurrencë të intensifikuar nga aktorë më të konsoliduar, si dhe nga prodhuesit e rinj me kosto të ulët në sektorët e prodhimit dhe shërbimeve.
- **Ndikimet e ndryshimeve klimatike:** Ngjarjet e dëmshme klimatike si thatësirat e zgjatura (që ndikojnë hidrocentralet dhe bujqësinë) ose kushtet ekstreme të motit (që ndikojnë infrastrukturën turistike) paraqesin rreziqe të rëndësishme për sektorët kyç të eksportit.
- **"*Ikja e trurit*":** Emigrimi i vazhdueshëm i fuqisë punëtore të kualifikuar, veçanërisht në sektorët me rritje të lartë si TIK, shëndetësia dhe inxhinieria, mund të përkeqësojë mungesat e fuqisë punëtore dhe të pengojë zhvillimin e kapaciteteve eksportuese me vlerë të lartë.
- **Qasje e kufizuar në financim për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM):** Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), veçanërisht në sektorin e tekstilit, shpesh përballen me qasje të kufizuar në produktet tradicionale bankare, duke penguar aftësinë e tyre për të investuar në teknologji, për të përmirësuar linjat e prodhimit dhe për t'u zgjeruar.
- **Paqëndrueshmëria e politikave fiskale:** Ndryshimet e shpeshta në politika fiskale apo në procedura mund të dekurajojnë investitorët dhe të prishin planet e eksportit.
- **Barrierat Jo-Tarifore dhe Standardet Teknike:** Përmbushja e standardeve të rrepta ndërkombëtare (veçanërisht të BE-së) të cilësisë, sigurisë, mjedisit dhe teknike për mallrat dhe shërbimet mund të jetë sfiduese dhe e kushtueshme për eksportuesit shqiptarë.
- **Rreziqet e Sigurisë Kibernetike:** Ndërsa sektori i TIK dhe digjitalizimi rriten, cenueshmëria ndaj kërcënimeve kibernetike është gjithashtu në rritje, duke ndikuar potencialisht në besueshmërinë e shërbimit dhe sigurinë e të dhënave.

8.5 Sfidat dhe potencialet

Integrimi i Shqipërisë në zinxhirët globalë të furnizimit është aktualisht "ende i pjesshëm" dhe kryesisht i përqendruar në "sektorët me vlerë të shtuar të ulët". Pavarësisht se përfiton nga afërsia gjeografike me BE-në, mungesa e infrastrukturës dhe teknologjisë konkurruese të Shqipërisë ka kufizuar pjesëmarrjen e saj në segmente më të avancuara të zinxhirëve globalë të vlerës. Një problem i madh strukturor për ekonominë shqiptare është varësia e saj nga importet për mallra thelbësore, duke përfshirë energjinë elektrike (veçanërisht në vitet me reshje të ulëta), produktet ushqimore dhe bujqësore, teknologjinë, pajisjet industriale dhe lëndët e para për prodhim.

Duke u fokusuar në aktivitete me vlerë të ulët, Shqipëria mbetet shumë e ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimeve globale dhe konkurrencës nga tregje më të mëdha dhe vuan nga mungesa e diversifikimit të

produkteve të eksportit.

Një ndër pengesat kryesore është mungesa e financimeve të duhura dhe investimeve në sektorët e orientuar drejt eksportit. Kjo pengon rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë. Një tjetër sfidë është mungesa e njohurive të thelluara për tregjet e huaja, gjë që e bën të vështirë për bizneset të identifikojnë dhe të hyjnë në tregje të reja. Aftësia për të arritur standardet e larta të cilësisë, veçanërisht për produktet bujqësore, mbetet një pengesë për aksesin në tregje si ai i BE-së.

Për më tepër, navigimi në kuadrin ligjor doganor në zhvillim, me zbatimin e pjesshëm të ligjeve të ndryshme dhe harmonizimin e vazhdueshëm me rregulloret e BE-së, mund të paraqesë kompleksitet dhe pasiguri për bizneset. Forcimi i lekut kundrejt monedhave të huaja, si euro dhe dollari amerikan, mund të ndikojë gjithashtu në konkurrueshmërinë e eksporteve shqiptare duke i bërë ato më të shtrenjta për blerësit e huaj.

Nga ana tjetër Shqipëria gëzon mjaft avantazhe të cilat duhen shqyrtuar me kujdes dhe duhen shfrytëzuar:

Afërsia gjeografike e Shqipërisë me Bashkimin Evropian është një avantazh i rëndësishëm i trashëguar që mund të shfrytëzohet për integrim më të thellë në ZNV. Ndryshimet aktuale globale në zinxhirët e furnizimit, të nxitura nga tensionet gjeopolitike dhe dëshira për rezistencë, paraqesin një mundësi të qartë për "nearshoring" – zhvendosjen e prodhimit më afër tregut evropian. Shqipëria është e pozicionuar mirë për të kapitalizuar këtë tendencë.[4] Tërheqja e më shumë Investimeve të Huaja Direkte (IHD) është thelbësore për nxitjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimit të ZNV. Ndërsa IHD-të e kaluara janë përqendruar në pasuri të paluajtshme dhe ndërtim, ka nevojë për të tërhequr IHD në sektorët e prodhimit, veçanërisht ato që janë relativisht intensive në njohuri, si automjetet dhe makineritë. IHD të tilla mund të stimulojnë integrimin në GVC, të gjenerojnë derdhje produktiviteti përmes lidhjeve të gjera dhe të lehtësojnë transferimin e njohurive dhe teknologjisë.

Tregjet niche prodhuese ku Shqipëria duket se ka një avantazh konkurrues bazuar në kosto përfshijnë përpunimin e metaleve, montimin e elektronikës dhe derdhjen e plastikës me injeksion. IHD në këto segmente mund të krijoj vende pune me aftësi të mesme dhe të larta dhe të forcoj bazën industriale. Në sektorin e shërbimeve, IHD në shërbimet turistike mund të krijojë jo vetëm vende pune, por edhe të përmirësojë infrastrukturën e udhëtimit dhe të ndihmojë në kalimin drejt segmenteve më të larta, veçanërisht duke pasur parasysh avantazhin konkurrues të Shqipërisë në turizëm.[53] Sektori i bujqësisë ofron mundësi të rëndësishme për zhvillimin e zinxhirëve të vlerës konkurruese, nxitjen e agroturizmit dhe krijimin e zinxhirëve të shkurtër të vlerës. Fushat specifike me potencial të lartë përfshijnë prodhimin organik, Ekonominë Blu (peshkimi dhe akuakulturë), perime të ndryshme (fushë dhe serë), qumësht dhe mish, ullinj dhe vaj ulliri, pemë frutore (përfshirë arrat), vreshtarinë, bletarinë dhe bimët aromatike.

Prandaj, programi i mbështetjes së eksportit duhet të synojë në mënyrë eksplicite dhe agresive përmirësimin e zinxhirit të vlerës. Kjo do të thotë zbatimi i politikave dhe stimujve që inkurajojnë firmat të kalojnë përtej outsourcing-ut të thjeshtë ose nxjerrjes së lëndëve të para në aktivitete me vlerë më të lartë brenda sektorëve ekzistues, si dizajni, markimi, ose përpunimi i avancuar në tekstile dhe minerale. Ai kërkon gjithashtu nxitjen e zhvillimit të sektorëve të rinj, më intensivë në njohuri dhe teknologjikisht të avancuar. Kjo kërkon një qasje strategjike për të tërhequr Investimet e Huaja Direkte

[53] https://blogs.worldbank.org/en/psd/western-balkans-should-leverage-foreign-direct-investment-integrate-global-value-chains

(IHD) që sjellin teknologji dhe njohuri, së bashku me investime të rëndësishme vendase në teknologji, inovacion dhe zhvillim të kapitalit njerëzor për të mundësuar firmat lokale të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga këto segmente me vlerë më të lartë.

9. Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (PNLE) 2026-2030

Vizioni i përgjithshëm: Transformimi i ekonomisë së Shqipërisë në një ekonomi më konkurruese, të diversifikuar dhe të orientuar drejt eksportit me vlerë të shtuar, duke shfrytëzuar si mallrat ashtu edhe shërbimet për t'u integruar më thellë në tregjet globale dhe evropiane, dhe për të arritur rritje ekonomike të qëndrueshme.

Objektivi kryesor i Programit është të hedhë themelet për një proces gjithëpërfshirës të krijuar për të forcuar performancën e eksportit të Shqipërisë dhe për të rritur rezistencën e saj në një mjedis dinamik të tregtisë globale.

9.1. Lidhja me Integrimin në BE

Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve është thellësisht i ndërthurur me procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Përmbushja e objektivave të këtij programi kontribuon drejtpërdrejt në adresimin e kritereve ekonomike të Kopenhagës, veçanërisht në aftësinë për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së.

- **Përafrimi me Legjislacionin e BE-së (Acquis Communautaire):** Veprimet e propozuara në PKIE, sidomos ato që lidhen me standardizimin, certifikimin, cilësinë e produktit dhe shërbimit, dhe thjeshtimin e proçedurave doganore, synojnë harmonizimin e plotë me *Acquis* së BE-së. Kjo përfshin Kapitullin 1 (Lëvizja e Lirë e Mallrave), Kapitullin 3 (E drejta e krijimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve), Kapitullin 11 (Bujqësia dhe zhvillimi rural), Kapitullin 12 (Siguria ushqimore), Kapitullin 15 (Energjia) dhe Kapitullin 27 (Mjedisi). Përputhshmëria me standardet e BE-së është thelbësore për të hequr barrierat jo-tarifore dhe për të lehtësuar qasjen në tregun unik të BE-së.
- **Forcimi i konkurrueshmërisë:** Përmirësimi i konkurrueshmërisë së sektorit eksportues, si objektiv kryesor i programit, është një nga kushtet thelbësore për anëtarësimin në BE. Një ekonomi më konkurruese, siç kërkohet nga Kriteret e Kopenhagës, mund të integrohet më lehtë në Tregun Unik Evropian dhe të përballojë presionin konkurrues.
- **Përfitimi nga Tregu i Vetëm i BE-së:** Programi synon të përgatisë eksportuesit shqiptarë për të shfrytëzuar plotësisht avantazhet e tregut të përbashkët të BE-së (me **mbi 450 milionë konsumatorë**), duke reduktuar barrierat tregtare dhe duke zgjeruar qasjen e tyre në këtë treg të madh.
- **Thithja e fondeve të BE-së:** PNLE është hartuar për të qenë në linjë me prioritetet e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III), duke mundësuar përthithjen efikase të fondeve strukturore dhe të kohezionit të BE-së për investime në infrastrukturë, inovacion dhe zhvillim të kapaciteteve. Kjo lidhje strategjike do të maksimizojë ndikimin e ndihmës së BE-së.
- **Nxitja e investimeve:** Një mjedis eksporti i fortë dhe i parashikueshëm, i synuar nga ky program, është thelbësor për të tërhequr IHD, veçanërisht nga vendet anëtare të BE-së, duke integruar më tej Shqipërinë në zinxhirët evropianë të vlerës.

- **Zhvillimi i NVM-ve:** Mbështetja e NVM-ve për eksport është thelbësore për integrimin, pasi ato përbëjnë shtyllën kurrizore të ekonomisë së BE-së. Fuqizimi i NVM-ve shqiptare për të eksportuar më shumë dhe për të përmbushur standardet e BE-së është një prioritet i përbashkët.

9.2. Lidhja me dokumenta strategjike

9.2.1 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve

Dokumenti më i rëndësishëm ku bazohet **programi i eksporteve** është Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHBI) e cila fokusohet kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe investimet. Kjo strategji shoqërohet me Planin e Veprimit për periudhën 2021–2027, e cila reflekton rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin për Shqipërinë për vitin 2020[54].
SZHBI është në linjë me dokumenta strategjikë dhe programe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të tilla si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), Programi i Reformës Ekonomike (ERP)[55], Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët 2021–2024 (CRM)[56] për BP dhe Strategjia e re e BE-së për NVM-të[57].
Qëllimi i politikës të SZHBI është "Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës" dhe zbërthehet në tre objektiva specifike: tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi, zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor.

9.2.2 Plani i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor (New growth plan for the Western Balkans)[58]

Me qëllim që t'u mundësojë partnerëve të rrisin reformat dhe investimet për të përshpejtuar ndjeshëm shpejtësinë e procesit të zgjerimit dhe rritjen e ekonomive të tyre, Komisioni i KE ka miratuar një plan të ri rritjeje për Ballkanin Perëndimor bazuar në katër shtylla, që synon:

- **Rritjen e integrimit ekonomik me tregun e vetëm të Bashkimit Evropian**, me qëllim që Ballkani Perëndimor të përafrohet me rregullat e tregut të vetëm dhe të hapë sektorët dhe zonat përkatëse për të gjithë fqinjët e tyre në të njëjtën kohë, në përputhje me Tregun e Përbashkët Rajonal;
- **Nxitjen e integrimit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Tregut të Përbashkët Rajonal,** bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së;
- **Përshpejtimin e reformave themelore**, duke mbështetur vendet e Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, përmirësimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal;
- **Rritjen e asistencës financiare nëpërmjet një instrumenti për Reformën dhe Rritjen për Ballkanin Perëndimor**, me vlerë 6 miliardë euro në mbështetje të pakthyeshme dhe

[54] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf
[55] https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Economic-Reform-Programme-2021-2023.pdf
[56] https://www.rcc.int/pages/143/common-regional-market
[57] https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/communication-sme-strategy-march-2020_en.pdf
[58] Miratuar në Bruksel në nëntor 2023

mbështetje kredie, me kusht që partnerët e Ballkanit Perëndimor që të përmbushin reformat themelore, dhe në veçanti reformat specifike socio-ekonomike.

9.2.3 Plani i Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM 2.0 Action plan)

Ky plan veprimi synon nxitjen e rritjes ekonomike dhe rritjen e konvergjencës socio-ekonomike të rajonit, duke e afruar atë me tregun e vetëm të BE-së, dhe zbaton shtyllën e dytë të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor: Integrimi ekonomik rajonal përmes Tregut të Përbashkët Rajonal.

Të gjitha shtyllat e planit të veprimit si lëvizja e lirë e mallrave dhe e shërbimeve, masat tregtare horizontale, zhvillimi i kapitalit njerëzor, mjedisi që mundëson biznesin dhe konkurrencën, transformimi digjital parashikojnë aksione dhe masa të cilat janë të lidhura direkt me zhvillimin e biznesit dhe lehtësimin e procedurave:

Shtylla e lëvizjes së lirë të mallrave ka për qëllim lehtësimin e tregtisë bazuar në rregullat e tregut të vetëm të BE dhe ku parashikohen aksione si :

- Harmonizim dhe pranimin e certifikatave për produkte të caktuara nga palët në kufi;
- Reduktimin e kontrolleve në kufi;
- Njohjen e rezultateve te analizave laboattorike, vleresimit te konformitetit;
- Njohjen e OEA ;
- Adresimin e problematikave të barrierave jo-tarifore.

Shtylla e masave tregtare horizontale promovon tregtinë pa letër dhe reduktimin e kohës së zhdoganimit në kufi dhe parashikon aksione të lidhura me:

- Korridoret e gjelbra dhe reduktimin e kohës në kufi;
- Bashkëpunimin e organeve që veprojnë në kufi;
- Njohjen e kontrolleve nga palët;
- Certifikata elektronike (në kuadër të CEFTA TRACES) dhe përdorimin e notifikimit të CEFTA.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor i cili fokusohet ndër të tjera në aksione si:

- Lehtësimi i 18 nismave të fokusuara në transferimin dhe komercializimin e njohurive nga akademia tek bizneset.
- Rritja e shpenzimeve në kërkim dhe inovacion (R&I) me 20%.
- Ofrimi i shërbimeve të integruara për industrinë përmes Qendrave të Inovacionit Digjital.

Mjedis mundësues i biznesit dhe konkurrencës, ku synohet krijimi i një peizazhi ekonomik që përputhet me standardet e BE-së, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm përmes financimit të qëndrueshëm, digjital dhe të konsumatorit, promovimin e investimeve të qëndrueshme dhe nxitjen e tranzicionit të gjelbër.

Transformimi digjital që ka për qëllim nxitjen e procesit të transformimit digjital në BP6 dhe afrimin e rajonit me Tregun Unik Digjital të BE-së. Masat e propozuara synojnë përafrimin me standardet dhe iniciativat e BE-së për ofrimin e mundësive të reja për bizneset, për të fuqizuar individët përmes aksesit digjital dhe për të forcuar bashkëpunimin midis BP6 në të gjitha aspektet digjitale.

9.2.4 Agjenda Kombëtare e Reformave

Miratimi i programit dhe nxitjes se eksporteve është një angazhim në kuadër të Agjendës Kombëtare të Reformave[59] e cila është hartuar në zbatim të nismës së Komisionit Evropian për Planin e Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të Paketës së Zgjerimit 2023. (RI[60] 1.1.6 masa 1).

AKR synon përshpejtimin e konvergjencës socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor krahasimisht me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, ndikuar sidomos nga pasojat që erdhën nga kriza ekonomike nga pandemia e COVID-19, si dhe kriza energjetike globale, si pasojë e agresionit rus në Ukrainë, përmes nxitjes, me objektiv dyfishimin, e rritjes ekonomike.

Dokumenti i politikës AKR 2024–2027 përcakton reforma/politika sipas qasjes, si më poshtë:

a) Politika me në qendër biznesin: masa në adresim të sfidave për tregun, forcimin e biznesit dhe ekonomisë, me synimin rritjen e aftësisë konkuruese në tregjet rajonale dhe përshpejtimin e integrimit në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, të sipërmarrjes vendase.
b) Qasje "Treg me treg": duke i shërbyer integrimit të tregut shqiptar në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, që përbën burim të rëndësishëm për rritje ekonomike, për të lehtësuar aksesin e sipërmarrjes në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian, si dhe bashkëpunimit në tregun rajonal, si bazë më e gjerë konsumatore dhe e partneritetit të zinxhirit të vlerës.
c) Transformim ekonomik: masa dhe hapa që nxisin, gjenerojnë dhe kanë ndikim në inovacion, specializim inteligjent, transformim tregu, aftësish dhe tranzicion energjitik/ digjital për një rritje ekonomike të qëndrueshme.
Në dokument parashikohen reforma indikative (RI) dhe hapa që kanë lidhje direkte me klimën e biznesit dhe lehtësimin e procedurave, promovimin e eksportit dhe ndërkombëtarizimin e ndërrmarjeve të tilla si :

- Miratimi i ndryshimeve ligjore për të lehtësuar procedurat administrative për bizneset (RI 1.1.4);
- Përgatitja e Udhërrëfyesit për të përmirësuar dhe lehtësuar praktikën e raportimit të biznesit (RI 1.1.4);
- Ratifikimi i Protokollit shtesë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave mbi "fletëshoqërimin elektronik" (eCMR) për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave (RI 1.1.5)
- Miratimi i ligjeve dhe përgatitja e akteve nënligjore për Kontrollet Zyrtare për Shëndetin e Kafshëve dhe për Shëndetin e Bimëve, në përputhje të plotë me Acquis të Bashkimit Evropian (RI 1.1.6);
- Progres i arritur në iniciativat rregullatore (Dhjetor 2025 / Qershor 2026) dhe/ose masat mbështetëse në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerës industriale me Bashkimin Evropian (RI 1.1.6);
- Progres i vazhdueshëm në zbatimin e iniciativave të Korsive të Gjelbra (Green Lanes) për lehtësimin e tregtisë, duke miratuar një program për lehtësimin e tregtisë dhe transportit (RI 1.1.6);
- Miratimi i Strategjisë së Sipërmarrjes Inovative (RI 3.2.1);
- Miratimi i akteve nënligjore për instrumente të mbështetjes së inovacionit, duke përmirësuar praktikën aktuale, në përputhje me praktikat e BE-së (RI 3.2.1);
- Përgatitja dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus në inkubatorët/përshpejtuesit, duke

[59] Miratuar me VKM nr. 621 datë 10.10.2024
[60] RI – Reforma Indikative

synuar zgjidhjet e gjelbra dhe/ose digjitale (RI 3.2.1);

- Përgatitja dhe zbatimi i një skeme grantesh me fokus tek SME-të dhe/ose startup-et, që synojnë zgjidhje të gjelbra dhe/ose digjitale (RI 3.2.1).

9.2.5 Strategjia e Specializimit Inteligjent

Strategjia e Specializimit Inteligjent (Smart Specialization Strategy – S3) lidhet ngushtë me zhvillimin e eksporteve shqiptare në disa pika kyçe, të cilat përbëjnë shtylla të rëndësishme të transformimit ekonomik dhe rritjes së konkurrueshmërisë ndërkombëtare të vendit:

1. Përzgjedhja e fushave prioritare me potencial eksporti. S3 synon të identifikojë dhe të mbështesë sektorët dhe nënsektorët ku Shqipëria ka avantazh konkurrues ose potencial të lartë për inovacion dhe rritje të vlerës së shtuar – shumë prej tyre me potencial të drejtpërdrejtë për eksport (si prodhimi, bujqësia, ICT, energjia, etj). Kjo përzgjedhje orientohet nga një analizë e thelluar e të dhënave ekonomike dhe inovative, duke u fokusuar aty ku investimet publike dhe private mund të sjellin rritje të eksporteve.

2. Mbështetja për modernizimin dhe inovacionin në sektorët eksportues. S3 promovon investimet në kërkim, zhvillim dhe inovacion në sektorët prioritarë, duke nxitur modernizimin teknologjik të ndërmarrjeve shqiptare dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare. Kjo përfshin:

- Financim për sektorë me fonde të pamjaftueshme, me potencial eksporti
- Modernizim infrastrukture dhe digjitalizim të proceseve prodhuese
- Nxitje të lidhjeve ndërsektoriale për produkte dhe shërbime të reja me vlerë të shtuar eksporti

3. Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale dhe diversifikimi i eksporteve. Strategjia S3 thekson rëndësinë e lidhjeve ndërsektoriale (p.sh. mes bujqësisë dhe përpunimit ushqimor, ICT dhe prodhimit), duke nxitur diversifikimin e produkteve dhe shërbimeve që mund të eksportohen. Kjo qasje ndihmon në zgjerimin e bazës së eksporteve përtej industrive tradicionale.

4. Përfshirja e aktorëve të katërfishtë (quadruple helix). S3 është zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës (Entrepreneurial Discovery Process – EDP), ku janë angazhuar qeveria, bizneset, akademia dhe shoqëria civile. Ky bashkëpunim rrit cilësinë e politikave për eksport dhe ndihmon në përafrimin e ofertës së produkteve/shërbimeve me kërkesat e tregjeve ndërkombëtare.

5. Mbështetje për SME-të dhe startup-et eksportuese. S3 parashikon instrumente të posaçme për mbështetjen e SME-ve dhe startup-eve, duke i ndihmuar ato të rrisin kapacitetin për të hyrë dhe qëndruar në tregjet e huaja, përmes financimit, trajnimeve dhe partneriteteve ndërkombëtare.

6. Ndërlidhja me politikat evropiane dhe aksesin në fonde. S3 është në përputhje me politikat dhe prioritetet e BE-së, duke i hapur Shqipërisë rrugën për të përfituar nga fondet evropiane për inovacion, zhvillim rajonal dhe promovim të eksporteve. Kjo rrit mundësitë për bashkëpunim ndërkufitar dhe integrim në zinxhirët evropianë të vlerës.

7. Promovimi i eksporteve si pjesë e objektivave të strategjisë. Në dokumentin e zbatimit të S3,

mbështetja për eksportet, investimet strategjike dhe integrimi në tregjet ndërkombëtare janë theksuar si prioritete të veçanta të strategjisë. Kjo përfshin masa konkrete për promovimin e produkteve "Made in Albania", pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare dhe krijimin e qendrave strategjike për eksport.

9.2.6 Programi Reformave Ekonomike (ERP)

Programi i Reformës Ekonomike (PRE) [61] për vitet 2025-2027, parashikon një rritje të qëndrueshme të PBB-së, e nxitur nga investimet dhe konsumi privat. Disa masa brenda PRE-së janë krijuar për të rritur rritjen e produktivitetit të firmave dhe janë indirekt të rëndësishme për konkurrencën e eksportit:

- **Heqja e barrierave për rritjen e kompanive:** Kjo përfshin eliminimin e përfitimeve tatimore për bizneset me qarkullim nën 14 milionë lekë, gjë që shihet si një disincentiv për rritjen.[19]
- **Promovimi i aksesit në financim:** Iniciativat për të përmirësuar sistemet e raportimit të kredisë, transaksionet e siguruara dhe regjimet e falimentimit, së bashku me zhvillimin e tregjeve të bonove të korporatave në fazë të hershme, synojnë t'u mundësojnë bizneseve të mbledhin më shumë fonde afatgjata për zgjerim.
- **Nxitja e prodhimit me vlerë të shtuar më të lartë dhe integrimi në GVC:** PRE njeh nevojën që firmat të rrisin investimet në teknologjinë ekzistuese dhe kërkimin dhe zhvillimin (R&D), si dhe për krijimin e rrjeteve të inovacionit për të lehtësuar përvetësimin dhe shpërndarjen e njohurive.
- **Përmirësimi i disponueshmërisë së aftësive:** Zbatimi i plotë i sistemit të arsimit dhe trajnimit profesional dual, përditësimi i programeve të trajnimit për t'u përafruar me nevojat e tregut të punës, dhe avancimi i agjendës digjitale janë prioritete kyçe. Zgjerimi i aksesit në "kujdesin e fëmijëve" theksohet gjithashtu si një mënyrë për të rritur pjesëmarrjen e grave në forcën punëtore.
- **Kapërcimi i pengesave infrastrukturore:** Edhe pse janë iniciuar disa projekte, duke përfshirë ndërtimin e një aeroporti të ri dhe porti turistik, rrjeti i transportit ende mbetet prapa ekonomive të BE-së, duke kërkuar investime të vazhdueshme për të përmirësuar lidhshmërinë.

PRE përshkruan një sërë të gjerë reformash makroekonomike dhe strukturore që janë themelore për rritjen ekonomike dhe, në zgjerim, mbështesin indirekt konkurrencën e eksportit. Këto përfshijnë stabilitetin fiskal, investimet kapitale dhe përmirësimet në mjedisin e biznesit dhe zhvillimin e aftësive.

Megjithatë, ndërsa përmend nxitjen e tranzicionit drejt prodhimit me vlerë të shtuar më të lartë dhe integrimin në zinxhirët globalë të vlerës, nuk duket se artikulon një strategji eksporti të dedikuar, eksplicite ose gjithëpërfshirëse me masa specifike dhe të synuara për të nxitur drejtpërdrejt eksportet përtej përmirësimeve të përgjithshme ekonomike.[1]

Për shembull, heqja e përfitimeve tatimore për bizneset e vogla, ndërsa synon të heqë një disincentiv për rritjen, mund të paraqesë gjithashtu një sfidë për eksportuesit në zhvillim nëse nuk menaxhohet me kujdes me mekanizma mbështetës kompensues. PRE ofron një kuadër makroekonomik të fortë, por veprimet e politikave specifike për eksportin janë më pak të detajuara.

Programi i propozuar i eksportit duhet të shërbejë si operacionalizimi i detajuar i qëllimeve më të gjera të PRE-së në lidhje me integrimin në GVC dhe prodhimin me vlerë të shtuar. Ai duhet të përkthejë

[61] Miratuar me VKM Nr.12, datë 11.01.2024

reformat e përgjithshme ekonomike në politika konkrete, të synuara dhe specifike për promovimin e eksportit. Kjo përfshin sigurimin që reformat fiskale, si ndryshimet tatimore, të jenë të dizajnuara për të shmangur dëmtimin e paqëllimshëm të eksportuesve në zhvillim ose të cenueshëm, dhe që zhvillimi i infrastrukturës të prioritizojë në mënyrë eksplicite logjistikën e eksportit dhe lidhshmërinë. Programi mund të ofrojë iniciativat specifike të nevojshme për të arritur ambiciet implicite të eksportit të PRE-së, duke siguruar një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të matshëm në performancën e eksportit të Shqipërisë.

9.3. Objektivat specifikë

Këto objektiva synojnë të përkthejnë qëllimin kryesor në rezultate të matshme dhe të arritshme, duke adresuar secilën prej shtyllave të programit:

1. **Përmirësimi i konkurrueshmërisë, cilësisë së produkteve/shërbimeve dhe vlerës së shtuar:** Fokus në përmirësimin e cilësisë, inovacionit dhe kalimin në zinxhirin e vlerës.
2. **Diversifikimi i tregut dhe qasja (digjitale dhe tradicionale):** Strategji për të identifikuar tregje të reja dhe për të lehtësuar hyrjen në treg si për mallra ashtu edhe për shërbime.
3. **Përmirësimi i infrastrukturës dhe logjistikës së eksportit (fizike dhe digjitale):** Investime në infrastrukturën kritike fizike dhe digjitale për të mbështetur tregtinë efikase.
4. **Forcimi i financimit të eksportit dhe mekanizmave mbështetës:** Ofrimi i shërbimeve financiare dhe këshillimore të aksesueshme dhe të personalizuara për eksportuesit.
5. **Ndërtimi i kapitalit njerëzor dhe inovacionit për eksportet:** Zhvillimi i aftësive dhe burimeve njerëzore të nevojshme për një sektor eksporti konkurrues.
6. **Promovimi i një klime të favorshme biznesi dhe investimi:** Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe mbështetës për bizneset e orientuara drejt eksportit.

Krahas objektivave që lidhen me rritjen e vlerës së eksporteve dhe diversifikimin sektorial e gjeografik, Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve përfshin edhe një objektiv makroekonomik kyç, në përputhje me Agjendën Kombëtare të Reformave (RA), konkretisht rritjen e eksporteve neto të mallrave dhe shërbimeve si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Në këtë kuadër, Programi synon që eksportet neto të arrijnë nivelin 40% të PBB-së deri në qershor 2027. Ky objektiv do të shërbejë si një tregues i qartë dhe i matshëm i rritjes së hapjes së ekonomisë shqiptare ndaj tregjeve ndërkombëtare dhe i ndikimit të politikave të nxitjes së eksporteve në performancën e përgjithshme ekonomike të vendit.

9.4. Shtyllat Kryesore të Programit

PNLE është strukturuar rreth katër shtyllave të ndërlidhura, secila duke adresuar aspekte kritike të zhvillimit të eksportit:

1. **Zgjerimi i aksesit në tregje të reja** për eksportuesit shqiptarë dhe rritja e diversifikimit dhe vlerës së shtuar të mallrave e shërbimeve.

2. **Lehtësimi dhe eliminimi i barrierave tregtare** administrative, teknike dhe financiare që pengojnë eksportin.
3. **Përmirësimi i aksesit në financë** për eksportuesit, duke ulur kostot dhe rreziqet e financimit.
4. **Fuqizim kapacitetesh** të NMV-ve dhe institucioneve mbështetëse dhe koordinim institucional për të përmbushur standardet ndërkombëtare, inovacionin dhe digjitalizimin.

9.5. Masat e detajuara, institucionet dhe afatet kohore

Programi për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve do të promovojë në mënyrë aktive integrimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zinxhirët globalë dhe rajonalë të vlerës, përmes forcimit të lidhjeve me kompani shumëkombëshe dhe investitorë të huaj të pranishëm në Shqipëri dhe në rajon. Kjo do të realizohet përmes mekanizmave të ndërmjetësimit të bizneseve (matchmaking), zhvillimit të programeve të furnitorëve vendorë, si dhe mbështetjes për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të cilësisë, certifikimit dhe qëndrueshmërisë.

Kjo qasje synon të rrisë pjesëmarrjen e NVM-ve shqiptare si furnitorë të besueshëm në zinxhirët e vlerës së kompanive shumëkombëshe, të nxisë transferimin e njohurive, teknologjisë dhe praktikave menaxheriale, si dhe të kontribuojë në rritjen e vlerës së shtuar dhe konkurrueshmërisë së eksporteve shqiptare.

1. Objektivi i përgjithshëm 1 – Aksesi në tregje dhe promovim

Kjo shtyllë synon të zgjerojë mundësitë për produktet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, duke u fokusuar në diversifikimin e mallrave dhe tregjeve, si dhe promovimin efektiv.

Objektivi specifik 1.1 - Informim

- **Masa 1.1.1** - Informim i detajuar mbi tregtinë në rajon, rregullat e eksport–importit, procedurat dhe dokumentacionet në kuadër të CEFTA-s dhe CRM 2.0 (në platformën/faqen e internetit të AIDA-s).

  Institucioni përgjegjës: AIDA, MEI, DPD, AKU, AKMVB

- **Masa 1.1.2** - Informim frekuent mbi rregulloret dhe standardet e BE.
  Institucioni përgjegjës: MEI, AIDA

- **Masa 1.1.3** - Fushatë periodike informimi dhe promovimi mbi lehtësirat doganore dhe të rejat në fushën e doganave: IDT (informacioni detyrues i tarifës) dhe IDO (informacioni detyrues i origjinës) – statusi i OEA (Operatorët Ekonomikë të Autorizuar) - Eksportuesi i Miratuar. Informim mbi konventën PEM (Pan Euro Med) dhe ndryshimet në fushen e rregullave të origjinës.

  Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

- **Masa 1.1.4 –** Miratimi i një programi/plan veprimi për lehtësimin e tregtisë që përfshin masa konkrete për implementimin e Korsive të Gjelbra (Green Lanes).

  Institucioni përgjegjës: MEI, DPD, AKU

- **Masa 1.1.5 –** Guidë përmbledhëse për eksportuesit mbi rregullat dhe provat e origjinës (preferenciale dhe jo-preferenciale).
  Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, AIDA

- **Masa 1.1.6** – Mbështetje/informim për mundësitë e bashkëpunimit me bizneset dhe institucionet e BE në sektorë prioritare.
  Institucioni përgjegjës: MEI

Objektivi specifik 1.2 - Diversifikim mallrash dhe tregjesh

- **Masa 1.2.1** - Kryerja e studimeve të tregut për identifikimin e niche-eve dhe segmenteve me potencial të lartë për produktet dhe shërbimet shqiptare, si dhe për zhvillimin e produkteve me vlerë të shtuar që mund të konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare.
  Institucioni përgjegjës: MEI

- **Masa 1.2.2** - Studim "Orientimi drejt Tregjeve të Reja" - Nxitja e eksportuesve drejt tregjeve jo-tradicionale, përtej BE-së dhe Ballkanit Perëndimor (Lindja e Mesme, Azia), përmes bashkëpunimit ekonomik dhe panaireve ndërkombëtare.
  Institucioni përgjegjës: MEI, AIDA

Objektivi specifik 1.3 - Promovim

- **Masa 1.3.1 -** Regjistrimi i markës kombëtare "Made in Albania", duke përfshirë ndërmarrjen e hapave ligjorë për regjistrimin e markës dhe logos përkatëse, si dhe përcaktimin e kritereve dhe kushteve për përdorimin e saj.

  Institucioni përgjegjës: DPPI, MEI

- **Masa 1.3.2 -** Promovimi i markës "Made in Albania" në tregjet ndërkombëtare përmes fushatave të strukturuara të marketingut digjital dhe tradicional, përdorimit të rrjeteve sociale, mediave dhe kanaleve institucionale, si dhe përmes mbështetjes financiare dhe logjistike për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve shqiptare në panaire rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë organizimin e takimeve të drejtpërdrejta me blerës dhe investitorë.

  Institucioni përgjegjës: MEI, AIDA

- **Masa 1.3.3 -** Zgjerimi dhe forcimi i rolit të diplomacisë ekonomike në promovimin e eksporteve dhe të markës "Made in Albania".
  Institucioni përgjegjës: MEI, MEPJ, AIDA

- **Masa 1.3.4 –** Hartimi dhe Promovimi i kalendarit të unifikuar vjetor të panaireve kombëtare dhe ndërkombëtare.
  Institucioni përgjegjës: AIDA

2. Objektivi i përgjithshëm 2 - Lehtësimi i Barrierave

Kjo shtyllë adreson sfidat dhe pengesat burokratike dhe rregullatore që ndikojnë në procesin e eksportit.

Objektivi specifik 2.1 - Lehtësim proceduarsh dhe barrierash jo-tarifore dhe kalimi në tregtinë pa letër

- **Masa 2.1.1** – Evidentimi i aplikimet, certifikatat, lejet etj., që lëshohen në letër dhe dixhitalizimi i tyre.
  Institucioni përgjegjës: MEI (sipas rastit : AKU, AKMVB, Agjencia e barnave, MIE)

- **Masa 2.1.2 -** Zbatimi dhe monitorimi i "Plani i Veprimit për Përputhshmërinë me Nenet 34-36 të TFEU-së".
  Institucioni përgjegjës: MEI

Objektivi specifik 2.2 - Lehtësim i barrës fiskale

- **Masa 2.2.1 -** Identifikimi e barrës fiskale të padrejtë dhe barrierave tarifore.
  Institucioni përgjegjës: MEI, MF

- **Masa 2.2.2 -** Identifikimi i niveleve të tarifës doganore të Shqipërisë dhe ndryshimet tarifore në krahasim me atë të BE, me qëllim vlerësimin e ndryshimeve mes tyre.
  Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

- **Masa 2.2.3 -** Hartim i një Guide për bizneset në lidhje me tarifat doganore që do jenë të zbatueshme në momentin e anëtarësimit në BE.
  Institucioni përgjegjës: MEI, DPD, MBZHR

3. Objektivi i përgjithshëm 3 - Mbështetje Financiare

Kjo shtyllë synon të sigurojë që eksportuesit të kenë qasje të lehtë në burime financiare për të mbështetur operacionet e tyre dhe për të rritur kapacitetet eksportuese.

Objektivi Specifik 3.1 - Skema mbështetese

- **Masa 3.1.1** - Hartëzim (mapping) i skemave mbështetëse ekzistuese.
  Institucioni përgjegjës: MEI

- **Masa 3.1.2** - Fonde për inovacion dhe digjitalizim: Mbështetje për ndërmarrjet që investojnë në transformim digjital dhe inovacion në proceset prodhuese dhe menaxheriale, në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030.
  Institucioni përgjegjës: MEI

- **Masa 3.1.3** - Krijimi i një fondi mbështetës për Gratë Sipërmarrëse për fuqizimin e bizneseve të drejtuara nga to.
  Institucioni përgjegjës: MEI

Objektivi Specifik 3.2 - Shfrytëzimi i burimeve të jashtme

- **Masa 3.2.1** - Mbështetje: informim, guida, dhe asistencë për aplikim në skema financimi dhe fonde, si dhe përmes mbështetjes për zhvillimin e aftësive.

Institucioni përgjegjës: MEI, AIDA

4. Objektivi i përgjithshëm 4 - Fuqizim kapacitetesh dhe koordinim

Kjo shtyllë fokusohet në zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme për eksportuesit, duke përfshirë trajnimin, këshillimin dhe modernizimin.

Objektivi Specifik 4.1 - Bashkëpunimi privat-publik

- **Masa 4.1.1 –** Nxitja e partneriteteve (nëpërmjet organizimit të tryezave specifike) ndërmjet sektorit privat, institucioneve arsimore dhe qeverisë për zhvillimin e zinxhirëve të vlerës dhe inovacionit, duke shfrytëzuar Këshillin Konsultativ të Ndërmarrjeve (KKN).

  Institucioni përgjegjës: MEI, KKN

- **Masa 4.1.2** – Forcimi i rolit të organizatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë në ofrimin e shërbimeve për eksportuesit.

  Institucioni përgjegjës: MEI, Dhomat e Tregtisë

- **Masa 4.1.3 –** Organizimin e seksioneve informuese nga Dhomat e Tregtisë në bashkëpunim me institucionet publike në lidhje me rregullat e reja në kuadër teë procedurave të eksporteve me vendet e BE-së dhe CEFTA

  Institucioni përgjegjës: Dhomat e Tregtisë, DPD, MEI, AKU

- **Masa 4.1.4 –** Programe Profesionale, Programe trajnimi të specializuara, Programe trajnimi dhe edukimi, Këshillim Individual.

  Institucioni përgjegjës: AIDA

Objektivi Specifik 4.2 - Mbështetje për Standardet dhe Certifikimet

- **Masa 4.2.1** - Krijimi ose forcimi i qendrave të testimit dhe cilësisë për të siguruar që produktet shqiptare të plotësojnë standardet ndërkombëtare.

  Institucioni përgjegjës: MEI, DPS

- **Masa 4.2.2** - Mbështetje për certifikime ndërkombëtare si dhe për subvencionimin e certifikimeve.

  Institucioni përgjegjës: AIDA

- **Masa 4.2.3** - Mbështetje (studim – informim) për Markimin CE dhe për Pasaportën Digjitale të Produktit.

  Institucioni përgjegjës: DPS

9.6. Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi efektiv janë thelbësorë për zbatimin dhe përshtatjen e suksesshme të PNLE. Në tabelën më poshtë, në bazë të objektivave të përgjithshëm dhe atyre specifik, janë reflektuar treguesit kryesorë të performancës (KPI) si dhe rritja e parashikuar për secilin prej tyre.

Objektivi i Përgjithshëm	KPI – Tregues të Matshëm të Performancës	Njësia e Matjes / Përqindja e Synuar deri në 2030	Institucionet Përgjegjëse për Monitorim
1. Aksesi në tregje dhe promovimi	• Rritja e vlerës totale të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve • Numri i tregjeve të reja ku hyjnë produktet shqiptare • Numri i kompanive pjesëmarrëse në panaire, misione tregtare dhe platforma ndërkombëtare • Numri i markave "Made in Albania" të regjistruara ndërkombëtarisht	• +7% mesatarisht në vit për mallrat • +10% mesatarisht në vit për shërbimet • Minimumi 3 tregje të reja çdo vit • 50 marka të reja të regjistruara deri në 2030	MEI, AIDA, MEPJ, Dhomat e Tregtisë, Shoqatat e Eksportuesve
2. Lehtësimi i barrierave	• Ulja e kohës mesatare për zhdoganimin e mallrave • Ulja e kostove administrative për eksportuesit • Përqindja e masave të lehtësimit të tregtisë të zbatuara sipas CEFTA/OBT	• -20% kohë zhdoganimi deri në 2030 • -15% kosto administrative • 100% zbatim të plotë të masave për lehtësimin e tregtisë	Doganat, MF, KKLT, AIDA
3. Mbështetje financiare	• Numri i kompanive që përfitojnë nga skemat e granteve apo garancive për eksport • Totali i fondeve të disbursuara për mbështetje eksporti • Rritja e kredive të buta për NVM eksportuese • Përqindja e bizneseve që raportojnë akses të përmirësuar në financë	• +500 kompani të mbështetura deri në 2030 • +50 milionë euro fonde totale të dedikuara • +25% rritje e kredive për eksport • 70% e bizneseve të kënaqura me aksesin në financë	MEI, MF, BERZH, AIDA, Shoqatat e Biznesit, OJQ financiare
4. Fuqizim kapacitetesh dhe koordinim	• Numri i punonjësve të trajnuar në MEI, AIDA dhe institucione të tjera	• +300 zyrtarë publikë •1,000 NVM të	MEI, AIDA, ASPA, GIZ

	• Numri i NVM-ve të trajnuara për gatishmëri eksporti dhe standarde ndërkombëtare • Krijimi i platformës digjitale kombëtare për eksportet • Indeksi i koordinimit ndërinstitucional (bazuar në vlerësime të palëve të treta)	trajnuara deri në 2030 • Platforma digjitale kombëtare funksionale deri në 2026 • +80% vlerësim pozitiv për koordinimin institucional	

- **Raportimi i rregullt:** AIDA, në bashkëpunim me INSTAT dhe ministritë e tjera përkatëse, të publikojë raporte tre-mujore dhe vjetore mbi performancën e eksporteve, progresin e zbatimit të programit dhe tendencat e treguesve kyç. Raportet duhet të publikohen në faqet përkatëse zyrtare.

- **Konferenca vjetore e rishikimit:** Organizimi i një konferencë vjetore, duke mbledhur zyrtarë qeveritarë, përfaqësues të sektorit privat, akademikë dhe partnerë ndërkombëtarë të zhvillimit.

- **Vlerësimi afatmesëm dhe përfundimtar:** Vlerësime të pavarura gjatë mesit të programit (fundi i vitit 2027) dhe në përfundim të tij (fundi i vitit 2030).

Indikatori i eksporteve neto të mallrave dhe shërbimeve si përqindje e PBB-së do të monitorohet në mënyrë periodike, në bashkëpunim me INSTAT dhe Ministrinë e Financave, si pjesë e kuadrit të monitorimit dhe vlerësimit të Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve. Të dhënat e këtij indikatori do të përdoren për të vlerësuar progresin drejt objektivit prej 40% të PBB-së deri në qershor 2027 dhe për të orientuar, nëse është e nevojshme, rishikimin dhe përshtatjen e masave të programit gjatë zbatimit të tij.